



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
ONr. 06-2346/16
KLINË, 25.3.2016

PROCESVERBAL
I SEANCËS SË III-të TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR, MË 25.3.2016, NË ORËN 10:00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KK, drejtorë të Ekzekutivit, mediet, OSB, OJQ-të, Zyra Ligjore etj.

Seancën e tretë të KK-së e hapi kryesuesi, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju uroj mirëseardhje në këtë seancë të KK-së. "Rendin e ditës e keni marrë me kohë, rreth rendit të ditës e hapi debatin", tha Kryesuesi.

Pal Berisha, tha unë propozoj një ndryshime të vogël për rendin e ditës, kërkoj që të përfshihet situata në shkollën e Jagodës në rend të ditës.

Haxhi Ibishi, kërkoi nga anëtari Berisha që të definohet diçka më shumë rreth kësaj çështjeje.

Pal Berisha, tha se unë mendoj që meriton të përfshihet si çështje në rendin e ditës, sepse besoj se informata ju ka ardhur, që atje bojkotohen orët e gjuhës shqipe, është e treta apo e katërta ditë që nxënësit bojkotojnë këtë lëndë mësimore, edhe unë mendoj që duhet të diskutohet meqë e kemi prezent drejtorin e Arsimit të jap përgjigje se çfarë është në pyetje krejt në detaje.

Haxhi Ibishi, tha se ne e kemi rendin e ditës, Pyetje dhe përgjigje, sigurisht që në këtë pikën e tetë në kuadër të pyetjeve, kjo faktikisht, mund të konsiderohet si pyetje e juaj, ndoshta DKA do të jep një përgjigje në pikën 8.

Tunë Dedaj, tha se unë nuk di pse nuk mund të jetë pikë e veçantë kur ne e dimë që atje mësimi nuk mbahet. "Më e rëndësishme është që të jetë si pikë e veçantë, se mësimi nuk është duke u mbajtur, se sa t'i iket asaj pyetje. Do të thotë, në e trajtojmë, e shikojmë dhe prezantojmë mendimet tona", shtoi anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, theksoi se në qoftë se ka diçka në urgjencë në pikën, Pyetje – përgjigje e kemi praktikuar kështu. "Unë konsideroj që në pikën 8, në kuadër të pyetjes që ngriti këshilltari Berisha, tash iu bashkëngjit edhe këshilltari Dedaj, DKA mund të jep sqarime", tha Kryesuesi

Fadil Gashi, tha se unë kisha propozuar që pika 6 e rendit të ditës, të hiqet prej rendit, sepse veç s'kemi material dhe nuk di se çfarë do të rishqyrtojmë, përpos një shkrese që ju e keni pranuar prej Ministrisë, edhe është mirë të ketë material, unë nuk di çfarë shqyrtojmë, as çfarë rishqyrtojmë. "Ne e kemi shkresën e Ministrisë që na është përcjellë edhe Vendimi që kemi marrë që ata e kontestojmë. Çfarë do të rishqyrtojmë sot?"- shtoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se atëherë kemi dy çështje të ngritura, në të 6-ën, Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin të Planit Rregullativ Hapësinor, kemi pasur disa gabime teknike, duhet për t'i proceduar në Kuvend, e kemi detyrë sot, që shkresën përcjellëse brenda afatit ligjor duhet ta procedojmë për vendim për rishqyrtim të Vendimit për

PRRH të Komunës së Klinës, e kemi obligim që afatin ligjor për ta respektuar. “A po pajtohemi që në pikën e 8-të të jetë, si Pyetje-përgjigje, që DKA këtë çështje të sqarojë”, shtoi Kryesuesi.

Pal Berisha, tha se kërkesa ime ishte të jetë si pikë e veçantë, sepse e meriton si çështje.

Halil Desku, tha se unë mendoj që më herët është vendosur për këtë rend dite dhe mendoj që nuk ka nevojë të ndryshojmë tash rendin e ditës, edhe unë nuk po di se çfarë ka për t’u diskutuar aty, sepse nuk po e di as atë problem, po ashtu mendoj që edhe shumica nuk e dimë, mirëpo unë besoj që ka për ta marrë përgjigjen e merituar pasi që këtu gjendet edhe drejtori dhe mjafton le të jetë në këtë pyetjen e fundit, përkatësisht le të shkojë si pyetje. “Edhe ashtu ne duhet miratuar rendin e ditës dhe mendoj që shumica janë për të mos vendosur pika të reja të rendit të ditës, tha prof. Desku.

Haxhi Ibishi, tha se mua me duhet për të vënë propozimin e këshilltarit Berisha në votim. “Ju kisha lutur për një konsensus, meqenëse është pika 8, ku realisht atë kohë, 15 minuta mund ta shfrytëzojmë për këtë çështje. Nuk po dëshiron për t’i ikë askush kësaj teme, mendoj që as Ekzekutivi për sqarime shtesë, prandaj unë mendoj që në pikën 8 t’i themi “po” dhe mund të debatojmë rreth kësaj çështjeje”, theksoi Dr. Ibishi.

Ndue Shabanaj, tha se unë po mendoj se dallimi ekziston në mes vendosjes si pikë e veçantë e rendit të ditës dhe Pyetje-përgjigje. “Sipas praktikës që kemi ne këtu, Pyetje – përgjigje, është kohë e caktuar, e limituar plotësisht, sa mund të zgjat pyetja dhe sa përgjigja dhe realisht kur gjendja që dëshiron të shqyrtohet në Asamblenë Komunale i tejkalon këto suazat e limitit kohor. Për t’u shqyrtuar diçka e tillë nuk ka vend për pyetje-përgjigje. Nëse ne merremi vesh që në atë pikë, Pyetje-përgjigje, nuk e limitojmë kohën, por e shqyrtohet derisa të shterret çështja e caktuar, atëherë për bindjen time nuk ka rëndësi se në cilën pikë është, a është e 8-ta në kuadër, Pyetje përgjigje, a është e 3-ta, por kur ka kërkesa të tilla të rëndësishme të veçantë, nëse ndërpritet mësimi në një shkollë, domethënë e ka rëndësinë. Unë kështu e dëgjova, nuk e di a është ndërprerë apo jo, por kështu u tha këtu, është bojkotuar mësimi, ashtu disi. Unë po mendoj nëse nuk e limitojmë kohën e shqyrtimit të saj nuk prish punë për të qenë në kuadër të pikës 8, Pyetje-përgjigje. Nëse shkojmë sipas praktikës sikur deri tash, se Pyetja – përgjigja, kjo pikë të zgjat krejt shkurt, atëherë nuk ka kohë për t’u shqyrtuar një pikë e veçantë”, vlerësoi prof. Shabanaj.

Sokol Bashota, tha se do t’ju ndihmojë në këtë drejtim: “Të shkohet te pika e rendit të ditës, Pyetje – përgjigje, duhet për t’u marrë vesh për limitin kohor, bëhet shkella e Rregullores së AK. Kështu që, si pikë e veçantë, edhe pse nuk ka shkuar përmes KPF-së, ju jeni ata që vendosni, se duam të shtrojmë debatin për aq sa ka nevojë për këtë çështje. Nëse vërtet është ashtu siç thotë këshilltari, apo propozuesi i kësaj pike, le të daltohet dhe le të sqarohet deri në fund rreth kësaj çështje, sepse mendoj që është shumë e ndjeshme dhe ka të bëjë pikërisht me diçka shumë vitale. Prandaj, më mirë është që të përfshihet si pikë e veçantë nuk është me rëndësi cila pikë do të jetë, me rëndësi që koha të mos kufizohet, se me siguri kanë edhe opozita, në këtë rast edhe pozita dhe mendoj që në këtë drejtim të dyja bashkë janë në shërbim zgjedhjes apo sqarimit të kësaj çështjeje”, theksoi kryetari Bashota.

Haxhi Ibishi, tha se me propozimin e Kryetarit, edhe propozimin e këshilltarit Berisha, e vendosim si pikë të veçantë, në pikën numër 8. “Kush është që t’i shtohet rendit të ditës pika: Debat rreth gjendjes në shkollën e Jagodës?”

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Me 27 për, pa kundër, u miratua propozimi që si pikë e rendit të ditës të shtohet: Debat rreth gjendjes në shkollën fillore “Atë Gjergj Fishta në Jagodë.

Haxhi Ibishi, theksoi se e kemi edhe shqetësimin e rendit të ditës nga këshilltari Fadil Gashi, mendoj që sqarimin ma mirëkuptuat. “Kush është që propozimi i Gashit, pika 6,

Fadil Gashi, tha se mos e merrni aq serioze, se unë po e di që tash po tërhiqet edhe Halili, se para se të flas Kryetari tha se rendi i ditës është vendosur. “Po, tash foli Kryetari, është mirë që ta respektojë edhe opozita. Edhe një herë po e përsërisë: mos e merrni seriozisht, por pasi që nuk e kemi materialin, realisht që ne e kemi debatuar jo një herë këtë çështje, edhe nuk e kemi pasur as në KPF, kjo vetëm ka ardhur sot. Po që se doni ne edhe në këtë mënyrë e votojmë, për ne nuk është problem, por unë po e shoh që 3-4 vjet nuk po keni mundësi të bëni këtë zgjidhje, për atë po them ta bëjmë një zgjidhje të përhershme, edhe të mos na kthehen këto. Në këtë aspekt, vetëm na tregoni si të votojmë ne”, shtoi anëtari Gashi.

Sokol Bashota, sqaroi çështjen. “Problemi është për dy shkronja. Për t’u hequr nga Vendimi një shprehje “ish”, vetëm kjo është. Procedurat tona është vetëm janë kryer, vetëm se është shkruar gabim me shprehjen “ish”. Kjo tregon se ka qenë një vendimmarrje më herët dhe më nuk është. Kërkohej një vendim formal i AK për t’u hequr kjo shprehje”, sqaroi Kryetari.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës kështu si është i propozuar, me pikën shtesë nga këshilltari Berisha.

Me vota unanime (27) u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2015,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për lëshim në diskutim publik të Projekt-rregullores për ndarje të bursave për studentë të rregullt të Universitetet e Republikës së Kosovës – për Komunën e Klinës (Ref. drejtori DKA-së),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për subvencionimin e klubeve sportive “Dukagjini” në Klinë (Ref. drejtoresha e DKRS),
6. Shqyrtimi i Vendimit për miratim të Planit Rregullues të Hollësishëm të Klinës – për harmonizim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor, Nr. 04/174 (Ref. Drejtorja e Urbanizmit),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për zëvendësimin e një anëtari të Komitetit për Urbanizëm, Ekonomiko dhe Zhvillim (pas tërheqjes së Ali Sylës),
8. Debati rreth gjendjes në shkollën fillore “Atë Gjergj Fishta” në Jagodë,
9. Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se s’ka mungesa nga ana e anëtarëve të KK.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Ramiz Rusta, tha se sigurisht është lëshuar një gabim te Raporti për shpenzimet për 2016, ku thotë që buxheti ka qenë 891631 euro, nuk është e vërtetë, është gabim teknik, se buxheti për 2015 ka qenë 8916031 euro.

Vuri ne miratim procesverbalin me vërejtjen e drejtorit Rusta.

Pika e tretë: Shqyrtimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2015.

Haxhi Ibishi, tha se ju me kohë e keni marrë materialin. “Këtë raport e kemi kaluar edhe nëpër KPF. Fjalën e barti te kryetari i Komunës, z. Sokol Bashota.

Sokol Bashota, prezantoi Raportin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2015. “Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të gjithë të pranishëm, Në harmoni me kompetencat e Kryetarit të Komunës, dhe me qëllim të ngritjes dhe fuqizimit të transparencës në Komunë, unë si Kryetar i Komunës, ofrojë para jush, këtë

raport me qëllim të ofrimit të informatave sa më të detajuara lidhur me punën e Ekzekutivit të Komunës. Ky Raport vjetor për vitin 2015, përfshin aktivitetet e të gjitha drejtorive dhe të zyrave të Komunës. Për një vit, të dhënat të cilët janë pasqyruar në këtë raport tregojnë se kemi arritur një progres të kënaqshëm, duke i përmbushur kërkesat e qytetarëve të Komunës, duke vazhduar dhe duke qenë çdo herë të gatshëm, për të arritura të mëtutjeshme në punën gjithëpërfshirëse të Komunës. Angazhimi i Ekzekutivit të Komunës gjatë kësaj periudhe, kryesisht është fokusuar në realizimin e kompetencave të plota sa i përket interesit lokal dhe që janë në interes për qytetarët, duke i pasur parasysh prioritetet. Edhe pse me një buxhet modest, sa i përket infrastrukturës, i kemi përmbushur nevojat parësore, siç janë: rrugët, ujësjellësi, kanalizimi dhe ndriçimi publik e tjera. Njëherësh kemi arritur të krijojmë kushte më të mira për qytetarët e Klinës e sidomos për familjet të cilat kanë qenë me nevojë për kushtet elementare të jetesës. Komuna e Klinës e ka përmbyllur me sukses vitin e kaluar 2015, duke realizuar gjitha synimet dhe objektivat që janë planifikuar gjatë vitit kalendarik. Janë bërë investime në fusha të ndryshme të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Janë realizuar 32 projekte në fusha të ndryshme, duke përfshirë shkolla të reja, kanalizime, ujësjellës, ndriçim publik, bujqësi, shëndetësi e fusha tjera. Kemi përmirësim të dukshëm në ofrimin e shërbimeve të qytetareve dhe mund të flasim për një administratë efikase që vazhdimisht ka qenë në shërbim të qytetarëve. Klina në vitet e fundit karakterizohet me një gjendje stabile të sigurisë. Ky segment i jetës dhe mirëqenies sociale të qytetarëve është trajtuar me kujdes të veçantë dhe janë arritur suksese të mira Janë përmirësuar dukshëm shërbimet shëndetësore si rezultat i investimeve të konsiderueshme zgjerimin dhe modernizimin e hapësirës të qendrave të mjekësisë familjare në qytet dhe në fshatra. Gjatë periudhës njëvjeçare janë publikuar disa qindra informata e të dhëna të dobishme për qytetarët, duke i kontribuar transparencës dhe llogaridhënies publike. Po ashtu, gjatë vitit 2015, janë mbajtur takime të shumta me përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare, si dhe organizata buxhetore, donatorë dhe OJQ të ndryshme. Në këto takime është potencuar nevoja e investimeve në sektorë të ndryshëm të jetës publike në Klinë. Kemi pasur takime të rregullta me organet qendrore qeverisëse dhe në bazë të kësaj kemi mundur të tërheqim donacione e mjete të konsiderueshme, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, shëndetësore, rrugore, sidomos në sferën e bujqësisë, blegtorisë, e tjera. Raportet tregojnë për një aktivizim të madh dhe intensitet të shtuar të punës në terren, komunikim të drejtpërdrejtë dhe veprime të pareshtura nga ana jonë, kujdesi i vazhdueshëm në mbarëvajtjen dhe cilësinë e punëve dhe realizimin e projekteve në terren, në mënyrë që nga gjithë kjo ndërmarrje e organizuar institucionale, qytetari ynë të shoh qartazi ndryshimet e vazhdueshme pozitive që po ndodhin në komunën e Klinës. Në pajtim me politikat programore kemi filluar rritjen e disiplinës në punë, duke e kthyer administratën publike komunale në servis për qytetarët pa dallim etnie, feje, grupi apo gjinie dhe duke e rritur efikasitetin e punës së Administratës komunale në përgjithësi. Rol të madh në sukseset e arritura përveç Ekzekutivit ka edhe legjislativi me miratimin e rregulloreve dhe vendimeve të shumta në të mirë të qytetarit. Komuna e jonë ka vazhduar bashkëpunimin e mirë me subjektet relevante vendore dhe ndërkombëtare. Bashkëpunimi me Institucionet Qendrore ka qenë në nivelin e duhur sipas dikastereve të ministrive përkatëse. Pastaj, bashkëpunimi me KFOR, USAID, OSBE-NË Ambasada dhe asociacione tjera ndërkombëtare. Në përgjithësi ka qenë një vit i suksesshëm, ku janë plotësuar synimet dhe objektivat e parapara”, ka nënvizuar në raportin e tij për vitin 2015, Kryetari i Komunës Sokol Bashota. I cili në vijim theksoi se edhe pse në materialet e juaji i keni edhe investimet kapitale më lejoni përciptazi t’i potencoj disa nga to, asfaltimi i rrugëve në Sferkë, asfaltimi i rrugëve në Përqevë, asfaltimi i rrugëve në Dush, rehabilitimi me zhavorr të rrugëve lokale, kanalizimi në Grabanicë – faza e dytë, kanali për ujitjen e tokave në Jagodë – faza e dytë, kanalizimi në shkollën e Jashanicës, ndërtimi i serave, ndërtimi i tribunave të stadiumit, furnizim me centrifuga për bletarë, furnizim me autofshisë për pastrimin e rrugëve, asfaltimi i rrugëve në Dobërdol, projekti ekzekutiv i sheshit, ndërtimi i nyjave sanitare në shkollën e “Motrat Qiriazit” në Klinë, ndërtimi i Çerdhes së fëmijëve, ndriçimi i qytetit, domethënë në rrugën e Mëhallës, furnizimi me kontejnerë për mbeturina, kanalizimi në Klinafç, dhe investimet e tjera të cilat i keni në raportin që e keni në duart e juaj, ka shtuar kryetari Bashota, i cili në vazhdim theksoi se krejt këtë raport që keni në dukje është pak voluminoz, por në qoftë se e përpjesëtojmë për ecuri nuk del shumë i madh. “Raportin e drejtorive unë nuk e kam censuruar, por nuk e kam bërë asnjë ndërhyrjen më të vogël në atë raport. Kam dashur ta lë si të tillë, për arsye sot i keni gjithë drejtorët e drejtorive komunale dhe për gjithçka keni të paqartë, do të jenë në dispozicionin tuaj. Më këtë rast kemi dashur që ky raport edhe të debatohet

nga asamblastët, me qëllimin më të mirë për të na shërbyer në të ardhmen, qoftë për defektet, qoftë për të arriturat, më të suksesshme”, ka konstatuar në fund kryetari Bashota.

Kryesuesi Ibishi, hapi diskutimit rreth Raportit.

Arben Limani, tha se në emër të grupit të asamblastëve të LDK-së po e bëj një rezymë gjithë atyre shqetësimeve që i kemi ngre gjatë gjithë vitit 2015, lidhur me punën e Ekzekutivit komunal në Klinë, shqetësime të cilat vazhdimisht kur janë raportuar i kemi ngritur, domethënë kanë qenë shpenzime të rasteve të tepruara që janë bërë, edhe që i kemi pasur evidencuar, duke filluar prej shpenzimeve të karburanteve, shpenzimet e riparimit të automjeteve, shpenzimet të telefonisë. Gjithashtu kemi pasur vërejtje të vazhdueshme se transparencë ka qenë e dobët nga ana e Komunës, ueb-faqja publikon shumë pak për të informuar qytetarët e komunës sonë, po ashtu edhe qasja në dokumente publike zyrtare ka qenë jo e mirë. Këto raporte i jep vazhdimisht edhe MPL. Grupi ynë i asamblastëve nuk e kemi votuar projekt-buxhetin e vitit 2016, për shkak të një projekti shumë të madh të ndërtimit të qytetit, përkatësisht sheshit të qytetit, i cili projekt kap vlerën 1.45 milionë euro dhe qëndrimi ynë si grup i asamblastëve ka qenë që për gjendjen aktuale në infrastrukturën e komunës sonë ka pasur prioritetet më të rëndësishme për t’u realizuar se sa ky shesh, edhe pse kemi pasur qëndrim që nuk jemi kundër, por gjithmonë duke i pasur parasysh prioritetet tjera. Komuna nuk ka ndërmarrë asgjë në parandalimin e ndërtimeve pa leje. Ato lulëzojnë çdo ditë, si në qytet po ashtu edhe në periferi, ku vlen të përmendet zona e rezervatit bujqësor, ku nga 9 shtëpi ku kanë qenë domethënë në kohën sa kemi qenë ne në pushtet, tash është bërë një qytet i vogël atje. Qyteti i Klinës edhe sot e kësaj dite mbetet pa ujë të pijshëm, edhe pse u dhanë afër 2 milionë euro, por ky problem ka raste edhe nëpër fshatra, edhe aty ku janë kryer ujësjellësit një pjesë e tyre nuk janë funksional. Po e përmendi fshatin Cerovik, Sferkë, Qupevë, Volljak e Gllarevë. Projektet që janë të kryera nuk mund të identifikohet asnjë projekt që mund të lavdërohet, duke filluar nga ndërtimi i kanalizimeve, ujësjellësve dhe rrugëve. Tek arsimi, trendi i pranimi të kuadrit vazhdimisht po shkelen kriteret, lihen të punojnë kuadro të pakualifikuar duke mos marrë kuadro të kualifikuar, edhe vërejtjet tona kanë qenë se është politizuar krejtësisht për shkak se këto shkelje janë evidentuar edhe nga Inspektorati i Arsimit. Gjendja në shëndetësi ka qenë pothuaj e pandryshuar, me shërbime jo të mira për qytetarët, bile nëpër QMF nëpër fshatra edhe nëse shkojmë me radhë, orari i punës është shumë i shkurtër, ka pasur ankesa edhe të banorëve, domethënë nuk e respektojnë orarin deri në fund. Gjithashtu tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, besoj që kanë mundësi të na japin edhe sqarime në lidhje me funksionimin e shumë prej çështjeve të cilat i preokupojnë qytetarët, mirëpo unë po dëshiroj të ndalem, të mos ju marr shumë kohë, tek funksionalizimi i shumë projekteve të janë realizuar vitin e kaluar, por edhe më herët. Domethënë ankesat të cilat vijnë nga banorët e fshatit Bokshiq, është se rrjeti i kanalizimit kur është kryer për një pjesë të lagjes së Zeqëve, d.m.th deri atje kanalizimi bëhet në një lagje tjetër çka i pamundëson ata edhe për të jetuar në atë lagje sidomos gjatë stinës së verës për shkak të kundërmimit që bën rrjedha e këtij kanalizimi. Gjithashtu kanalizimi një fazë është kryer në fshatin Grabanicë, por me një reshje shiu nga ankesat e banorëve domethënë menjëherë kanë filluar problemet e para me mbyllje të këtij kanalizimi. Ankesat e disa familjeve në fshatin Ujëmir, familjet e Mustafëve, domethënë komuna ka ndërtuar vetëm këmbët e një ure që dy vite ndërsa pllaka nuk po i vendoset edhe këto familje e kanë të pamundur të kalojnë sidomos gjatë stinës së dimrit. Në fshatin Dobërdol kanalizimi është kryer pjesërisht, edhe derdhja po ashtu e ujërave të zeza bëhet tek disa familje tjera të fshatit. Nuk e di këto rinovime që po figurojnë në buxhet që janë bërë të kanalizimeve, a po vërehen këto probleme lidhur me infrastrukturën që posedohet ose mbi këto projekte që po kryhen. Gjithashtu një ankesë po ashtu nga fshati Dobërdol rreth asfaltimit të rrugëve që është bërë, domethënë rruga është shumë e ngushtë dhe se premtimet nga zyrtarët komunal, edhe projekti ka qenë që rruga të jetë 4 metra me gjerësi, besoj që edhe për këto ka sqarime nga zyrtarët e Komunës. Për fshatrat, Sferkë, Qupevë, Volljak dhe Dush, ujësjellësi nuk funksionon që 5 vjet, gjithashtu edhe kanalizimi në fshatin Qupevë e Ulët ka mbetur në gjysmë, domethënë gypat janë shpërndarë nëpër fshat, por fshati nuk ka kanalizim. Në fshatin Gremnik nga ankesat që vijnë nga qytetarët që nga koha kur janë shtruar rrugët nëpër lagje ujësjellësi nuk funksionon. Ankesa e tyre vjen në mos janë prishur gypat e ujësjellësit gjatë ndërtimit të këtyre rrugëve. Gjithashtu shqetësim paraqet mos intervenimi në rrugën Qeskovë-Këpuz, që shihet si një rrugë e domosdoshme për udhëtimin që e bëjnë nxënësit nga fshati Qeskovë në Këpuz,

atyre ju duhet që të udhëtojnë rrotull, të bien nëpër Dollovë për të shkuar në shkollë. Ky sipas banorëve, edhe këtu është deklaruar se është prioritet i Komunës, besoj edhe për ankesat e qytetarëve është arsyeshmëria. Gjithashtu, edhe në fshatin Siqevë ujësjellësi është, por besoj duhet të kemi sqarime pse ai ujë nuk përdoret nga banorët, ujët është krejtësisht i papijshëm. Gjithashtu edhe kanalizimi në fshatin Zajm, pse nuk është përfshirë lagjja te shkolla, komplet lagja nuk është përfshirë në kanalizim, dhe a parashihet që këto kanalizime që janë të mbetura në gjysmë edhe ku nuk janë të përfshira lagjet, sic e kemi rastin edhe në Gjurgjevik të Madh, ku banorët organizohen me vetëfinancim që të lidhen në rrjetin e kanalizimit, edhe të ujësjellësit. Pse nuk bëhen projekte për gjithë fshatin po lihen kështu në këtë mënyrë gjysmake gjitha këto kanalizime. Gjithashtu në fshatin Jagodë kanalizimi është jashtë funksionit, diku ankesa e banorëve është se para 4 viteve thuhet se kanë filluar punimet në këtë projekt edhe nuk është funksionalizuar asnjëherë. Në një rrugë të fshatit Krushevë që po shtrohet nuk e di a është rrugë fshati, ai punëkryerësi e merr rërën e Drinit aty dhe një prej banorëve tha se unë e kam marrë prej atij punëkryerësi dhe po blej zall-tha- po na shërben, edhe pse është i ngarkuar me tjetër punë nga ana e Komunës në atë projekt, edhe kanalizimi në fshatin Budisalc ka mbetur ashtu, kam dëgjuar se është vetëm faza e parë, por punët kanë ngecë që një kohë të gjatë. Gjithashtu edhe në fshatin prej nga vi unë, ujësjellësi nuk është funksional që një kohë të gjatë, kanalizimi po ashtu ka mbetur gjysmak i pakryer si duhet bile edhe lagja më e madhe në fshat nuk është përfshirë fare në këtë kanalizim. Domethënë, këto sqarime, por edhe me plotësim të kolegëve të tjerë ndoshta kanë mundësi për të na i dhënë zyrtarët komunal”, ka konstatuar anëtar i Limani.

Skënder Merturi, tha se po më vjen mirë që po shihmi, pasi në seancën e parafundit nuk kam mundur të marr pjesë për shkaqe që tashmë janë të njohura për gjithë Klinën dhe jashtë Klinës, për krejt Kosovën, mënyrën e arrestimit, edhe pas procesit një muaj ditë burg politik prej regjimit të Qeverisë që do ta kemi edhe për disa ditë. “Tash po kthehem te raporti që kemi marrë, unë kam disa vërejtje në vija të trasha, jo në ato detajet sa i përmendi Arbeni, pajtohem me ato që i tha Arbeni në detaje, unë do të shkojë qysh janë të renditura drejtoritë, për disa kam vërejtje, për disa nuk kam vërejtje të mëdha. Drejtoria e Administratës, si Drejtoria e Administratës dhe administrata në përgjithësi nuk është aq shumë funksionale sa ka mundësi për të qenë për t’ju përgjigjur kërkesave të qytetarëve më shumë sidomos besoj që është në kompetencat e administratës edhe kërkesat që vijnë prej qytetarëve dhe qasja në dokumentet publike, dhe besoj që një lloj përgjegjësie është edhe e kësaj drejtorie që nuk përgjigjen kurrë dhe qytetarët kurrë nuk i marrin përgjigjet në kërkesat që na i drejtojmë në përgjithësi të administratës dhe të drejtorive të caktuara nuk marrim përgjigje. DFEZH përpos vërejtjeve që i kemi përmendur në çdo raport tremujor nuk shihet që ka ulje të shpenzimeve te kjo drejtori. Në përgjithësi të gjitha drejtoritë harxhojnë shumë. Çdoherë kemi dhënë vërejtje për shpenzime të mëdha sidomos në ato që i potencoi Arbeni, në telefona, në derivate, dreka, darka etj., ka shpenzime të mëdha dhe besoj që është përgjegjësi dhe detyrë e kësaj drejtorie edhe për t’i menaxhuar edhe për t’i kontrolluar drejtoritë tjera të mos i lejojë të shpenzojnë shumë mjete financiare të parasë publike. Buxhetin për 2016 nuk e kam votuar, kam qenë kundër. DKA nuk i ka kryer detyrat, tash po dihet punësimet qysh po shkojnë në këtë drejtori, pa pasur librezën e partisë në pushtet nuk mund të hysh as pastrues i shkollës, lëre për të dhënë mësim në cilëndo shkollë në qytet apo fshatra. Tashmë kjo është bërë rutinë. Në përgjithësi sistemi i arsimit është i degraduar, në kuadër të këtij degradimi është edhe arsimit në nivelin komunal në Klinë pavarësisht disa shkolla që janë ndërtuar i gëzohem atyre shkollave që janë ndërtuar, është bërë mirë, edhe pse diku-diku, edhe pse në bazë të disa analizave në një kohë jo të gjatë do të vijë deri te mbyllja e atyre shkollave, sepse nuk ka nxënës, por megjithatë janë ndërtuar, si objekte janë të mira, edhe pse nuk i plotësojnë kushtet kur dihet që nevojat për shkollë e domosdoshme është për shkollën “Ismet Raci”, në qendër të Klinës, ku edhe e kemi numrin më të madh të nxënësve, por për fat të keq nuk e dimë pse nuk ndërtohet një shkollë. Jam ihtar i asaj që ne ta fillojmë punën vetë për të ndërtuar një shkollë në Klinë, me bindje të madhe që do të gjejmë donatorë edhe brenda edhe jashtë vendit, por duhet një seriozitet më i madh. Këtu fajtor shoh prej kryetarit të Komunës, DKA-në dhe drejtorin e shkollës së Klinës, që tek e fundit ata duhet marrë hapa për ta bllokuar derën e Komunës derisa të merret një vendim, por drejtori i shkollës “Ismet Raci” është politik, edhe shkon puna qysh shkon edhe në atë shkollë edhe në shkollat tjera. Për mendimin tim nuk ka logjikë dhe nuk ka arsyetim pse nuk fillohet ndërtimi i shkollës “Ismet Raci”. Drejtoria e Urbanizmi dhe Mbrojtjes së Ambientit, janë shtruar disa asfalte si ai në Dobërdol, është shumë i ngushtë, është

shtruar një asfalt sa të themi. Janë shtruar edhe disa rrugë, kanalizimet nuk janë kryer qysh duhet, rrjeti i ujësjellësit, ka shumë fshatra që e kanë rrjetin e ujësjellësit por ujë nuk kanë, ne e dimë që as Klinë nuk ka ujë të pijshëm, se lerë nëpër fushra në përjashtim të atyre që furnizohen me puse, qytetarët e Klinës e blejnë ujë. Puna e ujëve tek ne është bërë seria që nuk po mund të kryhet kurrë edhe po vazhdon njëjtë. Besoj që me ndërrimin e qeverisë do të rregullohet edhe ujë e pijshëm. Rreth sheshit po ju njoftoj se jam në procedim të procedurës për dërgimin e lëndës së sheshit në sistemin e drejtësisë. Jam kundër dhe do të vazhdojë të jem kundër këtij sheshi. Përveç ndërtimeve që po shihen DU nuk i ka kryer detyrat e veta qysh duhet. Kemi mungesë të planeve që duhet t'i kemi ne si Klinë edhe nuk i zbatojmë edhe po që se i kemi. Kjo drejtori përpos atyre që i potencoi Arbeni, nëpër shumë fshatra edhe nuk ka asfalt, edhe janë kërkesa të shumta për rregullimin e rrugëve. DSHPE, meqenëse nuk kam qenë këtu kam qenë në burg kur pati rënë ky shiu i madh, por i kemi pasojat e të reshurave më të hershme, që më gjithë që edhe presidentes që ka thënë se do të bëj në atë drejtim, shpresoj të kemi gabuar, unë nuk e di që është bërë diçka lidhur me këtë rast që banorëve në ato zona ku janë përmbysur për t'ju kompensuar ose të merren masa të mos ketë përsëritje, prandaj si komunë nuk ju kemi dalë në ndihmë këtyre banorëve në kohën e duhur. Përpos një makine që është blerë nga kjo drejtori dhe e kam potencuar si punë të mirë, aty s'ka asgjë të mirë. Nuk është duke u mbajtur pastrimi i duhur i rrugëve të qytetit, por edhe në disa fshatra e di që ka filluar një projekt për grumbullimin e mbeturinave për të gjitha fshatrat e Klinës, por nuk e di a është tamam nëpër të gjitha fshatrat, do të kisha pasur dëshirë të gabohem, drejtori do të më përmirësojë, që mblidhen nëpër të gjitha fshatrat mbeturinat. Drejtori le të na tregojë që punëtorët që bëjnë pastrimin e rrugëve mbi çfarë bazë e bëjnë, a kanë siguri këta punëtorë, a kanë kontratë, apo qysh janë të punësuar, në kuadër të kompanisë apo si? Drejtorja e Inspektoratit i mbijnë ndërtesat nuk e di a janë me leje, çka po merren masa, cilat masa po merren për objektet që janë pa leje, a ka diçka konkretisht për t'i rritur ato objekte apo s'ka. Drejtorja për Kulturë, mirë që është bërë rinovimi i stadiumit atje, aktivitetet kulturore për rini na mungojnë. Klubi "Dukagjini" po besoj se është duke ecur mirë këtu Drejtorinë për Gjeodezi po e kaloj për shkak të kohës etj.," ka konstatuar anëtarë Merturi.

Vlora Tafilaj, tha se u fol rreth projekteve edhe rreth drejtorive, unë desha të ndalem te zyrat të cilat funksionojnë në kuadër të Komunës së Klinës, edhe kushdo që ka bërë këtë projekt nuk i paska pasur punët mirë me statistika. "Unë nuk po di këto aktivitete që po shkruajnë këtu kur janë zhvilluar, sepse nuk kemi asnjë rezultat të aktiviteteve. Jemi duke folur së pari me statistika, ka lëndë që janë pranuar, ka lëndë që janë në proces, edhe ka edhe ka lëndë që janë refuzuar, për lëndë që janë përfunduar nuk po shkruan fare. Tek disa zyra tjera që nuk i kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre, edhe shumë zyra tjera nuk i kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre. Po lexoj se kanë pasur vizita, kanë identifikuar probleme, por asgjë më shumë. Kjo po kallëzon se vetëm janë duke e mirëmbajtur gjendjen e cila ndodhet në Komunën e Klinës. Ky janë rezultatet e këtyre aktiviteteve? Edhe çka është më e rëndësishmja nuk po e shoh raportin e punës së Zyrës së Prokurimit, e cila ka qenë shkaku kryesor që janë zvarritur tepër punët në Komunën e Klinës, kemi pasur shumë raste, ka qenë edhe rasti i mos kontraktimit për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonit dimëror. Pse po mungon kjo?"-shtoi anëtarja Tafilaj.

Pal Berisha, tha se unë së pari do ta falënderoj Kryetarin e Komunës për ndërhyrjen që bëri që kërkesa ime të përfshihet në rendin e ditës. "Dhe tash kam një pyetje për Kryetarin lidhur me punimet që po kryhen, përkatësisht lidhur me investimet kapitale: Kryetar, unë kam përshtypjen që disa nga punimet që po kryhen janë të kualitetit shumë të dobët, a ka ndodhur që ju apo ndokush nga Ekzekutivi juaj të ndjek ndonjë kompani që nuk e ka kryer punën sipas kontratës së paraparë, domethënë, dyshohet në kualitet apo diçka tjetër. A ka ndodhur që ju të ndërmerrni masa kundër ndonjë kompanie? Edhe një çështje tjetër të cilët më duhet ta përmend lidhur me punën që është kryer vitin e kaluar, e potencoi edhe Arbani, kanalizimin në fshatin Jagodë i cili është jofunksional që 5 vjet. Po është edhe diçka tjetër shumë brengosëse lidhur me shkollën e Jagodës. Shkolla e Jagodës që disa vite nuk ka ujë, nuk ka nyje sanitare, dhe nxënësit e kësaj shkolle duhet të ikin të dalin prapa shkolle për nevojat e tyre. Kjo shkollë po ashtu ka një kulm të mbuluar me tabela, të cilat llogariten që janë shumë të dëmshme dhe kancerogjene. Drejtori i DKA-së mos ta merr diçka që kam kundër tij mirëpo duhet t'i

bie ndërmend ndonjëherë se edhe në Jagodë ekziston një shkollë e cila ka nevojë për diçka që të investohet”, theksoi anëtarë Berisha.

Filloreta Berisha, tha se po ia nisi të Raporti i shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2015, për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit kemi tri kode, domethënë, shpenzim jashtë vendit 3530 euro, akomodim zyrtar jashtë vendit 36 euro, shumë interesant, akomodim zyrtar jashtë vendi 36 euro! Shpenzime tjera zyrtare jashtë vendi 3 476, domethënë tri kategori për një shpenzim. Shpenzime të telefonit 24,000, shërbime të ndryshme shëndetësore 10 euro, çka janë këto 10 euro; shpenzime kontraktuese tjera 87,000 euro s’e dimë çka janë, domethënë të na sqarohet pak kjo shifër, kah janë shkuar 87, 000 euro; pajisje tjera më shumë se 1000 euro, 19922 euro, unë për vete nuk e kam të qartë, 20,000 euro janë në pyetje, furnizime të zyrës 51,000 euro, po me duket pak e tepërt, furnizim-ushqim në pije jo dreka 17,000, furnizime mjekësore 12,000, naftë për ngrohje qendrore 18,000, karburante për vetura 89,000, regjistrim i automjeteve 4883, regjistrim i sigurimit të automjeteve 8883, domethënë krejt një kategori mbi 100, 000 euro më shumë, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve 21,000 euro, për mendimin tim këtu do të isha ndaluar më shumë ndoshta e kam gabim, por mirë do të kishte qenë po të jetë gabim, 21,000 euro për t’i mbajtur veturat më mirë do të ishte për t’i shitur në ankand kah 300 euro, e për t’i marrë 2-3 vetura të reja, se sa për të na kushtuar kaq mirëmbajtja e atyre. Mirëmbajtje e pajisje të mobileve 2554, çfarë mirëmbajtje për mobilie, kaq shumë para për mirëmbajtje të mobilieve; dreka zyrtare 17,000, kemi pak një zvogëlim prej vitit të kaluar, kjo është shenjë e mirë, mirëpo do të kishte qenë mirë që të zvogëlohet akoma më shumë; shpenzime të vendimeve të gjykatës, i kemi dy kategori, pagesa gjyqësore po ashtu i kemi dy kategori, pajisje tjera janë 30,000 përkatësisht 29130, duhet pasur një emër kah janë shkuar këto shpenzime, të na sqarohet çka janë këto “pajisje të tjera?”. Edhe kapitalet tjera i ke 284,000, çka janë këto? Pagesa vendime gjyqësore janë i keni dy kategori, një është 336,364 dhe tjetra 3106. Dua të ndalem te Drejtoria i Shëndetësisë, sikur para dy viteve kur e kemi thirrur për interpelancë drejtorin prej kur ka marrë detyrën, gjendja është e njëjtë, kam pasur shumë dëshirë atëherë kur kam biseduar me te se pasur appetite të mëdha për atë pozitë që ka marrë dhe besoj se kam pasur një besim të ai se ka për të arritur diçka për ta përmirësuar shëndetësinë, mirëpo definitivisht jam bindur se nuk ka asgjë në këtë drejtim. E ka shkruar “Plotësim të standardeve të mundshme të kujdesit primar shëndetësor”, nuk e ka këtë standard të plotësuar në zbatim të mjekësisë familjare nuk e ka se nuk i zbaton, disa kritere po, por në tërësi nuk është duke i zbatuar. Mbulim më personel mjekësor në të gjitha qendrat dhe ambulancat nuk e ka, momentalisht e ke Jashanicën pa doktor, e ke shqetësim, furnizimi me listë të barnave esenciale, hiq asgjë më tepër të mos hyrët, vetëm shiringe të mos ketë në ambulancë është turp për Komunën e Klinës. Po turpërohem të më thotë një qytetar po shkoj për ta blerë një shiringe! Doktorë e di, Kryesuesi, sa kushton një gjilpërë. E kemi të vizitat mjekësore të ndarë në kategori, mirëpo unë po e them krejt në shumën e përgjithshme, gjatë këtij viti në total vizita janë kryer 80 891 vizita, që i përkrahi dhe i mbështes doktorët edhe gjuhë shërbyesit që kanë kryer këtë punë kaq të madhe, kaq voluminoze, por për mua është e pakuptueshme, por edhe për gjithë qytetarët duhet të jetë, participimi është 23 298 euro prej afër 90,000 shërbimeve që janë kryer gjatë këtij viti. Pse po them është shqetësuese dhe ka vend për hetime këtu, po bazohem në një shembull: 1 euro kushton vizita për t’u kontrolluar te një mjekë familjar, 2 euro nëse shkon te mjeku familjar dhe nëse merr udhëzimin për të shkuar te specialisti, nëse shkon direkt te specialisti kushton 5 euro një vizitë; nëse e bën një laborator, 1 analizë kushton 3 euro, nëse e bën një rëntgen kushton 3 euro, por e marrim kategorinë e mundshme, por që janë të obliguara për të bërë pagesë, domethënë prej moshës 18 vjeçare e deri në moshën 48-50 vjeçare që obligohen për të paguar nëse nuk kanë dokument tjetër që i liron prej pagese ose për sëmundjet kronike. Prej 80, 000 vizitave duke i hequr këto kategoritë që janë të liruar prej pagese, diku krejt sa kam pasur mundësi për t’i llogaritur janë 46,000 vizita, prej kësaj shifre të vizitave vetëm nga 1 euro te mjeku familjar për t’u kontrolluar është dashur për t’i pasur 46,000 euro. Unë e di të sigurt vetëm dr. Haxhiu ka pasur diku 6 mijë vizita, prej 6 mijë jam e sigurt së pak 1500 kanë paguar te doktorë, 150, të merret mesatarja, po që se është shkuar në formë zyrtare 3 euro, kushtojnë goxha do para, domethënë diku 6-7 mijë euro dr. Haxhiu i ka bërë participim, pa hyrë në kategoritë tjera që janë këtu, participimi 23 mijë euro, vizita 46 mijë vizita të mundshme për pagesë definitivisht është pak. Këtu duhet për të hyrë ndokush për të hulumtuar pse është ky buxhet kaq i vogël i pagesës së participimit. Për mua shqetësuese po ashtu është edhe ndërprerja e kontratës e CARITAS-it, që për mua është gabim nëse janë kryer gjithsej 10 mijë

vizita domethënë prej këtyre punëtorëve që kanë pasur kontratë me ta, është një shqetësim për Komunën e Klinës, prandaj duhet gjetur mënyrën se si duhet për t'u marrë me këtë çështje, për t'u aktivizuar kontratat me CARITAS-in, për ta bërë një marrëveshje se 10 mijë shërbime janë një punë shumë e madhe", ka konstatuar Dr. Berisha.

Ndue Shabanaj, tha se dua t'i them dy thënie, një është si duket e Onore de Balzak, ku i thotë shokut: "Kërkoj falje që s'kam kohë të të shkruaj shkurt". Dhe, po dua për t'u thirrur në arsyeshmërinë tonë për të qenë konkret dhe të shkurtër edhe për t'i kontribuar kësaj. Dy: Për shumë vërejtje që janë këtu dëshiroj ta them një thënie tjetër: "Derisa i varfëri ka problem që s'ka çka han, i pasuri ka problem që i mungon apetiti". Ne jemi në një komunë, ku ka shumë projekte të zhvilluara, të iniciuara, të përfunduara; ka vende që s'ka fare dhe po merremi më shumë ke këto që mungon kjo, mungon ajo. Një çështje që e kemi ngritur vazhdimisht dhe po e ngrisim prapë sot po me duket e paarsyeshme. Ne kemi dhënë vërejtje periodikisht në çdo raportim, në raport tremujor, që i kemi pasur vazhdimisht dhe prapë të njëjtat po i përsërisim. Po me duket se jemi duke e zgjatur pa kufi. Kërkesa ime është për ta rrumbullakësuar sa më shkurt", theksoi prof. Shabanaj.

Lorenc Marleku, tha se së pari qasja e opozitës besoj në pushtet nuk është vetëm përmes AK, ma thoni po që se është ndryshe, edhe këtu kërkohet të cungohet nuk po di si ta karakterizoj ndryshe. "Të jem më transparent, më të shkurtër dhe të mos përsëriten gjerat dhe të shkojmë mandej. Cila është qasja e opozitës në pushtet, vetëm asambleja. Kështu që asamblistët mund të shprehen lirshëm, ka mundësi që kjo seancë të zgjas edhe një ditë tjetër po që se paraqitet nevoja, të gjithë kanë të drejtë për t'i shprehur ato brengat edhe të arriturat kanë mundësi për t'i cekur nëse ato ekzistojnë. Unë së pari shumë nuk i kisha përsëritur shumë çështje, gjegjësisht do t'i anashkaloj edhe ashtu na u dhënë disa vërejtje. Për ndriçimin publik, ndriçimi publik nuk duhet të jetë është një rrugë serbe atje duhet gjithmonë për të shkuar. Ne kemi pasur të asfaltuar rrugën Dollcit njëzet vjet para nesh, shteti i kaluar e ka ndërtuar dhe nuk i ka ardhur keq, ka ardhur deri aty dhe ka shkuar për Dollc. Njëzet vjet mbrapa ne e kemi ndërtuar këtë asfalt këndej. Tash edhe 20 vjet ne duhet pritur ndriçimin, për të shkuar andej, të mos vije këndej për shkak të disa serbëve atje. Respekt për serbët dhe gjithë qytetarët, por le ta kemi atë farë sensin pak se edhe ne jemi pjesëtarë të këtij shteti, që e kemi ndërtuar të gjithë. Ndërtimi i rrugëve, kisha pasur dëshirë të më tregojë drejtori, një projekt i rrugëve, kur ndërtohet rruga, kur jepen paratë e fundit të asaj rruge? Asnjë rrugë që është ndërtuar në komunën e Klinës, nuk i plotëson standardet as minimale, absolutisht, asnjë rrugë. Edhe cilën pjesë të asfaltit e keni çuar atje në Institut për ta vërtetuar a është kualiteti i asfaltit apo nuk është si duhet, asnjëra. Tjetra, në fshatin Përqevë – Sferkë, Dush Sferkë, krejt rrugët shtrohen rrugë lokale, që qytetari mua më thotë mos ta shtroni rrugët se na i vjedhin drutë se nëpër mal e keni sjellë asfaltin, pa participim, asnjë rrugë në Lugun e Drinit nuk e keni shtruar pa participim, asnjë rrugë, asnjë metër. Tjetër, kur jemi te siguria, kryetari tha se këtu ka siguri, unë nuk pajtohem, kisha pasur dëshirë që komandanti për të na treguar statistikën e vitit 2014 e 2015 për sigurinë në Komunën e Klinës, gjendja është shumë alarmante, komandanti e di, vetëm në lagjen tonë 3-4 thyerje brenda dy ditëve. Ne duhet ruajtur sikur në kohën kur ruajtshim dikur, se dini mirë qysh ruajtshim. Kërkoj nga komandanti statistikën të sakta për 2014 dhe 2015, po që nuk i keni tash për në seancën e ardhshme. Tjetër, thuhet 5 mijë euro janë dhënë për gropat në qytet, sa metra asfalt shtrohen me 5 mijë euro? 12 euro 1 metër asfalt, kanë shkuar ato. Te rruga "Nënë Tereza" janë gropat që pesë vjet nuk mbushën, e këtu thuhet 5 mijë euro janë dhënë për gropat në qytet. Penda në fshatin Krushevë, për 2-3 mijë euro nuk funksionon, gjithë ato fshatra mbesin pa ujë për një ndërhyrje të vogël. Po shkojmë te firmat, 78 firma janë të regjistruara 36 janë të ç'lajmëruara për një vit, kjo për mua është alarmante. Kjo shkon në dëm të buxhetit tonë dhe duhet analizuar pse ka ardhur deri te kjo. Cili është shkaktari, a janë taksa e mëdha apo cili është shkaktari pse ka rënie në çdo lëmi të jetës. Te ujët, ujët vjen i ndotur i turbullt dhe nuk ka ujë të pijshëm. Ujët vjen krejtësisht të ndotur, as për t'i larë duart nuk bën, nuk di si ka mundësi të jetë i pijshëm dhe kur do të jetë i pijshëm. Te vërshimet, janë qasje që ne duhet potencuar, tash ne jemi vërshuar, Marlekët atje janë vërshuar, sepse devijimi i Drinit ka shkuar në atë formë që një rritje e vogël ujët vjen tek ne. Ajo ndërhyrje mund të kushtojë 2-3 mijë euro. Drini ka devijuar krejtësisht, bash në pjesën ku kam unë diku 30-40 ari, vetëm një ndërhyrje e vogël që nuk është duke u bërë. Për mendimin tim prej Urës se hekurit siç e quajmë ne deri te Ura e Drinit, urgjenca më e parë e asamblesë, do të kishte dashur qenë që prej ekzekutivit do

të ishte dashur që të bëhet shtrati, së paku për të ndërhyrë sikur u është ndërhyrë disa të tjerëve, si Deskëve, Racëve te Ura e Haxhisë. Te Inspektorati kamë një vërejtje, aty thuhet se ne kemi inspektuar, kush është dënuar në Klinë për duhan? Në gjitha lokalet e Klinës pihet kafja, s'ka askund arkë fiskale, a ka shtet këtu", ka theksuar anëtari Marleku.

Haxhi Ibishi, tha se askush nuk po dëshiron të ngulfat debatin, por vetëm me qëllim informacioni për të shkëmbyer në mes vete.

Petrit Palushi, tha se unë desha të ndërlihem pak në shëndetësi, në vitin 2015 gjendja në shëndetësi ka qenë alarmante, ka pasur mungesë të materialit kryesor, shiringat, pambukut dhe gjithë materialit tjetër që është parësor, përkatësisht primar. "Në QKMF kemi pasur një problem, ku afër 17 punëtorë higjiene-teknike që pastrojnë QKMF-në dhe ambulancat tjera nëpër fshatra nuk kanë marrë paga që 4 muaj dhe ata po bojkotojnë punën. Aty ka pasur mbeturina me thasë që i ka ngjarë një kantine jo një institucioni shëndetësor, dhe nuk e di se çfarë është bërë me ata punëtorë, apo çfarë do të bëhet me ta, a duhet të punojnë ata apo nuk duhet punuar. Po që se nuk duhet punuar bile mos t'ju humbim kohën", tha anëtari Palushi.

Haxhi Ibishi, tha se pa dashur për të politizuar, mirëpo nuk e njihni këtë problem. "Nuk janë punëtorë shëndetësorë, janë të kompanisë private, që është një procedurë, domethënë jeni komplet në adresë të gabuar në diskutim," shtoi Kryesuesi.

Petrit Palushi, tha se po që se nuk janë punëtorë shëndetësorë mos t'i leni për të punuar dhe mos ua humbni kohën që 4 muaj, a punoni ju pa paga?-shtoi anëtari Palushi.

Haxhi Ibishi, sqaroi se ata nuk janë punëtorë shëndetësorë, punëtorë shëndetësorë janë ata që janë brenda sistemit të pagave në shëndetësi.

Petrit Palushi, tha se nuk thashë se janë punëtorë shëndetësorë, e thashë punëtorë higjiene-teknikë."Kush i paguan ata, a ka mundësi për ta ditur? E dyta, kam një shqetësim nga banorët e fshatit Krushevë e Madhe, atje për 15 vjet nuk është investuar asnjë cent. Nuk ka kanalizim, nuk ka ujësjellës dhe nuk ka asfalt, vetëm para luftës serbët që kanë shtruar një. Po ashtu u tha që janë ndarë 5 mijë euro për shtrim të gropave, në Budislac, Stupë dhe Klinë nuk e di a kaloni ndonjëherë, a janë ato fshatra me komunë tonë apo të Pejës a do të shtrohen ato gropat ndonjëherë. Ku të kërkojnë përgjegjësinë ata qytetarë, sepse paguajnë taksa", theksoi anëtari Palushi.

Tunë Dedaj, tha se mendoj që është e vërtetë që kemi tepruara më diskutime, mirëpo shqetësimet janë dhe po që se flitet më gjatë mendoj se nuk ka asgjë të keq. "Unë kam dy shqetësime, gjendja në arsim është shumë e keqe dhe nuk flas më tepër për këtë punë, edhe me drejtorin për Shërbime Publike e kam një shqetësim: Kam dëgjuar se është bërë një kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, edhe kam dëgjuar se është ndërprerë puna se ka dashur të sjellë dhe në vend të zhavorrit, edhe rrugët janë të pashtuara, janë shqetësuese. I kma fotografuar dhe mund t'ju sjell si dëshmi në seancë. Domëthenë, pse nuk penalizohet ajo ndërmarrje që ka marrë për të mirëmbajtur rrugët e tash nuk dëgjon për ta sjellë zhavorrin në bazë të kontratës", theksoi anëtari Dedaj.

Enver Gashi, tha se unë dua të ndalem te dy drejtori. "Kur ta lexoj Raportin e punës së ekzekutivit janar dhjetor 2015, po ndalem te DSH, fitohet përshtypja se gjendja është shumë e mirë në shëndetësi në Komunën e Klinës. Edhe këtu po ndalem te QMF në Sferkë, gjendja është shumë-shumë e rëndë. Por, si shqetësim kryesor i shumë qytetarëve është mungesa e ilaceve esenciale, pastaj në ambulancë nuk ka asnjë pikë ujë. Pastaj kemi raste kur doktorë të ndryshëm nga QKMF mungojnë. Një doktor të vetëm që kemi në Sferkë atë na e merrni dhe na e dërgoni në Klinë edhe shpesh QMF në Sferkë mbetet pa doktor të vetëm. Po ashtu DSHP thotë kemi bërë rehabilitimin dhe zhbllokimin e kanalizimeve në gjithë territorin e Komunës së Klinës. Kemi disa fshatra, si Volljaku, Sferka, ku gypat e kanalizimit janë të mbyllur që një kohë të gjatë dhe paraqitet rrezik i madh për përhapjen e ndonjë epidemie. Te DU me siguri është gabim teknik, te projektet, thotë: "Vazhdimi i objektit banesor, vazhdimi i ndërtimit të shkollës Sferkë, Përqevë dhe Jashanicë", me siguri këtu gabim teknik është.

Edhe një përgjigje këtu te Lorenci, po ia përkujtoj Lorencit se Komuna ka për obligim të investojë në të gjitha fshatrat, e në veçanti në fshatin e Sferkës, e ka obligim shumë më të madh, Lorenc, se atë nuk e di”, shtoi anëtarë Gashi.

Rasim Millaku, tha se unë e kam lexuar raportin të tërën dhe kisha dashur për të filluar kësi lloji: “Rrugët shtrohen, domethënë investimet kapitale, kryesisht nëpër komuna edhe në komunën tonë bëhen për t’u shtrohen rrugë për të qarkulluar më lehtë nëpër rrugë, sepse jashtë rrugëve qarkullimi me automjete është shumë i vështirë. Edhe dalja nga rendi i ditës nënkupton daljen nga rruga. Unë doemos më duhet për t’ju bërë një vërejtje Kryesues, se ne po dalim prej rrugëve në terrene tjera, që s’janë të përshtatshme për lëvizje zgjatet seanca gjithëve dhe të lidhur për temën. Kam pasur ndërmend ta analizoj gjithë këtë raport, sepse bashkë me Arsim Culajn kam punuar për disa vite në përpilimin e gjithë raporteve ekzekutive, dhe një vërejtje që kam dashur për ta bërë është vëllimi shumë i madh. Nëse analizojmë veç dy drejtori, Ekonominë dhe Shëndetësinë, më nga 19 faqe, 30 faqe, marrin gjysmën e raportit. Dominojnë tabela jostandarde të njëjta dhe racionalitet me përmbajtje, kisha dalluar Bujqësinë, Kadastrin, Urbanizmin, Administratën dhe Arsimin. Ka gabime në Drejtorinë e Inspektoratit shumë, prezantohen disa shifra të mos i përmend të mos ju marr kohë, dhe potencohet nëpër dy drejtori, plani i punës, Drejtori për Ekonomi thotë: Sipas Planit së miratuar”, tjetra, Drejtorja për Inspektorat thotë: “Sipas Planit të punës”, unë e mbaj mend që s’kemi miratuar plan të punës. Për të mos marrë kohë këto ishin vërejtjet e mia të lexuara në raport. Ju kisha lutur që të përmbahemi në raport ose në çdo pikë që e kemi për detyrë për ta diskutuar”, konstatoi anëtarë Millaku.

Lorenc Marleku, tha se kisha kërkuar prej Rasimit për të na treguar konkretisht ku kemi devijuar prej rendit të ditës?

Haxhi Ibishi, tha se nuk është Rasimi që ta jep vlerësimin se ku keni kaluar.

Sokol Bashota, tha se nga diskutimi, apo nga kërkesa e asamblistit Fadil Gashi në një seancë kur ai ka pasur një raport të tillë e di se kurrë nuk e kemi votuar, jemi dakorduar që vetëm për t’u njoftuar me raportin. “Jemi dakorduar për ta bërë të tillë kështu dhe kështu vërtet jemi dalë jashtë rendit të ditës. Disave u është ngatërruar edhe 2016-ta, me raportin e 2015, sepse u fol për disa veprimtari të Ekzekutivit të vitit 2016, të cilat nuk janë të përfshira në raport. Në pika të shkurtra po bëj përpjekje për t’ju ndihmuar drejtorëve pak, kur bëhet fjalë për shpenzimet është drejtori, le të flas Ramiz Rrusta, ueb - faqen po e pranoj, le për të dëshiruar akoma, u potencua qysh në fillim, u potencuan ndërtimet pa leje, po u përmenden me një theks të veçantë për kohën kur ne kemi qenë në pushtet. Desha tan pyes Arbenin, për cilën periudhë e ka pasur, se dy herë keni qenë në pushtet, Arben. Nuk dita për cilën periudhë e ke pasur fjalën. Edhe në atë kohë kur keni qenë në pushtet ka pasur ndërtime pa leje. Vetëm desha të di për cilin pushtet e ke pasur fjalën. Sa i përket ujësjellësit në Cerovik, edhe unë, edhe ti, po ashtu është edhe Ramizi këtu, është mirë për të shkuar e për t’ju thënë: “paguani shpenzimet e rrymës”- se ujë ka boll. Edhe në Sferkë, po ashtu, se 49 euro për 6 muaj ka shkuar inkasanti për t’i mbledhur në Sferkë për ujësjellës, mendoj që s’është shumë e madhe. Nuk di, a po e dini, me ujësjellësin “Hidrodrini” menaxhon me te. Ne vetëm e kemi bërë këtë punë, 15-20 milionë, ndoshta më shumë, duke e përfshirë edhe atë periudhën e kohës kur ka qenë LDK-ja në pushtet, ndoshta prej pas luftës mbi 20 milionë i kemi kanë hyrë përkatësisht që i kemi dhënë kompanisë, domethënë i ka marrë ajo, domethënë “Hidrodrini”. Në Ujëmir, te Mustafët, jemi dakorduar me këto familje, njërën këmbë të urës ata të bëjnë, një tjetër dhe një urë për ta marrë ata diku, mirëpo ne i kemi bërë të dyja ata s’kanë bërë asgjë, ka mbetur ashtu pezull deri në momentin që krijohen mundësitë për ta bërë këtë investim. Riparimet në kanalizime janë dhjetëra vende ku qytetarët i mbulojnë shatet, edhe në Sferkë, edhe në Cerovik, edhe në shumë fshatra. U përmend rruga e ngushtë në Dobërdol, ajo është bërë me kërkesën e qytetarëve, të cilët edhe e kanë firmosur kërkesën për ta bërë të tillë në mënyrë që për të përfshirë edhe rrugën e varrezave, pra është një kërkesë e qytetarëve me nënshkrime dhe deklarata, që kanë bërë ata dhe për dijeninë tuaj që u tentua që të dezinformohet asambleja, pikërisht unë rrallë mungoj në momentet të këtilla, pikërisht kur është bërë përrurimi i kësaj rruge nuk kam qenë. Prandaj nuk është mirë për t’i gënjyer njerëzit publikisht. Për cilësinë e ujit tash “Hidrodrini” është, i cili të jeni të sigurt nga statistikatat e fundit mbi 24 e sa janë marrë dhe ka dalë që ujët është i cilësisë së pijshëm. Kanalizimi në Jagodë

nuk është problemi te ne, është te qytetarët dhe nuk kemi mundur për të bërë diçka. Për shesh jemi, ata që i kanë bërë "argatin drejt" janë vonuar pak, se Agjencioni Antikorrupsion e ka marrë lëndën edhe e ka vlerësuar komplet tërë procedurën të këtij sheshi dhe e ka kthyer si të rregullt, kështu që pak me vonesë. Pali pyeti për kualitetin e dobët, nuk di mbi cilën bazë është thirrur, seriozisht se kur të bëhet një deklaratë është mirë për t'u mbështetur në argumente. Janë dokumentet të cilat mund t'i merrni, nuk ka rrugë që nuk u nënshtrohet atesteve dhe shkojnë në qeveri. Rrugët bëhen me atest, asnjë rrugë që është shtruar deri me tani nuk është që nuk është realizuar në raport me kushtet e tenderuesit. E kam thënë publikisht dhe po e them prapë, që gati-gati këto janë më tepër emergjente edhe pse fatbardhësisht po them gati gjitha rrugët që janë bërë gjatë mandatit tim, gati-gati mbi 90 për qind janë ende të shfrytëzueshme mirë. Kam qenë i shtrënguar për ta shkëputur kontratën me CARITAS-in, po ju tregoj shkurt, përpos një akti human që ka pasur për t'i punësuar nja 15 veta, dhe ato familje kanë siguruar nga pak kafshatën e bukës, e shihni edhe vetë se sa shërbime, në bazë të raportit të tyre janë kryer. Në Krushevë të Madhe, është një pendë rreth 100 mijë euro që është bërë, është shumë pak krahasuar me nevojat që ka, por është paraparë edhe për këtë vit që s'e ke votuar këtë buxhet, për t'u bërë edhe një kanal për ujitje në Krushevë. Është keq për t'u ndarë kështu nëpër fshatra dhe rajone, por realisht janë këto mundësitë, por është mirë nganjëherë për të mos i mbyllur sytë dhe të thuhet s'e votoj buxhetin., nëse dëshironi ta bëni edhe ju si opozitë, unë kam për ta realizuar. Unë kam bërë përpjekje për t'i realizuar ato prioritetë ku janë më të nevojshme dhe më të domosdoshme. Edhe kjo është në pika të shkurtra, që ka ndokush diçka le të vazhdojnë t'u drejtohen drejtorëve. Seriozisht u stërgjatë shumë debati për këtë raport", ka konstatuar kryetari Bashota.

Bedri Gashi, tha se desha për dy çështje që u potencuan: "Unë mendoj që më tepër janë të ngritura si hipoteza, sa mbi argumente dhe dëshmi. Çështja e listës esenciale dhe të hyrjes së barnave në QKMF, në QMF dhe AMF: Në raport figuron shumë mirë, nëse në listën esenciale vjet ka pasur 29.8 për qind më shumë, e sivjet janë më shumë në listën esenciale, do të thotë ky është një fakt, përkatësisht është një sukses yni që znj. Filloreta duhet për të pranuar. Ose, nëse sivjet kemi rritje në masën 58 për qind në shifrën, domethënë të listës esenciale, ose 50 mijë euro, që domethënë kemi blerje. Është e pamundur nganjëherë edhe të sigurohen. Zoti Limani ngriti orarin e punëtorëve shëndetësorë në QKMF dhe QMF. Orari është duke u respektuar, ne kemi monitoruar vazhdimisht QMF-të dhe AMF-të. Edhe tjetra, për shkak të zbatimit të ZHVP-së, gjatë krejt vitit janë mbajtur ligjërata, trajnime, fushata, kemi pasur fushatën njëmuje etj., etj., ku punëtorët shëndetësorë të AMF dhe QMF-ve kanë marrë pjesë gjatë orarit të punës një orë, eventualisht dy orë maksimumi, edhe kjo është ligjore brenda orarit, këto bëhen në tërë Kosovën. Këto janë dy çështje që them se nuk kanë pasur argumente për atë që u tha", theksoi drejtori Gashi.

Ramiz Rrusta, tha se ne e kemi bërë raportin për shpenzime për vitin 2015 dhe në mënyrë të detajuar kemi raportuar këtu para juve, edhe kemi paraqitur të gjitha shpenzimet që janë bërë për atë periudhë, edhe besoj që kemi rënies të shpenzimeve, duke filluar prej karburanteve, telefonave, ju kam thënë edhe në seancën e kaluar, që bashkë me kryetarin dhe BD kemi marrë vendim që të gjithë drejtorëve të cilët i kanë tejkaluar shpenzimet për vitin 2015 në bazë mujore, t'u ndalet të gjithëve nga paga, duke filluar nga vetja dhe gjithë drejtorëve tjerë. "Te disa shpenzime që u potencuan, janë potencuar edhe në seancat e kaluara, janë udhëtimet brenda vendit, ato janë udhëtime që drejtori i Arsimit i di, që janë shpenzime që i bëjnë nxënësit me nevoja të veçanta, që shkojnë në Prizren dhe në Pejë, dhe të gjitha shpenzimet e nxënësve të tjerë. Te raporti që është bërë voluminoz, DEFZH e kemi bërë një raport prej 8 faqe, jo më shumë, e di që edhe kur ju Rasim e keni bërë raportin me Arsim Culajn edhe unë kam qenë njëri prej drejtorëve, dhe kam dëshirë që atë raportin e juaj që keni bërë atëherë ta krahasojmë me këtë raportin që po e bëjmë tash", theksoi drejtori Rrusta.

Filloreta Berisha, tha se është duke më shqetësuar fakti që ju sot e keni marrë me shqetësim rreth kësaj pune. "Me këtë rast e kam me drejtorin e Shëndetësisë, unë punoj në një vend ku kam shiringa, në ambulancën e Klinës ka mungesë nganjëherë se s'ka shiringa, edhe këto janë fakte. Nëse nuk janë fakte ju kallëzoni, por kjo është e vërteta, drejtor, nuk jam duke gënjyer asnjë gjë. Për mua është shqetësuese, pse një qytetar nuk e gjen një shiringë?! Nëse për ju është okej, atëherë në rregull. Unë e di se kemi mungesë nganjëherë të barnave esenciale, por nëse në Prishtinë mund të menaxhoj një menaxheri imi, pse Komuna e Klinës nuk ka mundësi për

të menaxhuar për një rast urgjent. Kjo është arsyeja. Edhe nuk dha arsye për shumën tepër të ulët të participimit kur dihet se ka pasur 80 mijë vizita”, pohoi dr. Berisha.

Skënder Merturi, tha se befasohem qysh nuk kemi kamera që na përcjellin e të dal në medie ky debat. “Tendencë për ta ngulfatur zërin e opozitës është e tmerrshme, është tepër shqetësuese. Duke i parë asamblistët kënde, drejtorët, kryetarin, kryesuesin, për ta ndërprerë këtë debat sa më shpejt, nuk mund ta kuptoj. Pse e kemi marrë votën që kemi ardhur këtu? Pse e kërkojmë nesër votën prapë për të ardhur këtu? Kjo tendencë ta ndalojmë zërin mos të flasim, ta kryejmë është e pakuptimtë. Një raport një herë në vit kryetari këtu e sjell një raport 80-90 faqe sa i ka, edhe “mos flisni! Krejt është në rregull ky raport, mos flisni ju se s’keni të drejtë për të folur se kur të flisni keni 1 minutë, edhe vlerësojeni fjalët se çfarë po flisni!” Kjo nuk shkon kështu. Është raport njëvjeçar i ekzekutivit. Duam të diskutojmë po që se paraqitet nevoja edhe nesër për të vazhduar. Edhet të hënën, po këtë temë. Edhe një seancë tjetër e mbajmë. Ne jemi opozitë duam të diskutojmë fije e për pe, prej faqes së parë deri në faqen e fundit. Atëherë pse e keni sjellë kur nuk na lini për të diskutuar. Thoni, nuk duam diskutime, s’duam debate, ky është raporti ia pafshi hairin, nuk ka diskutim këtu. Nuk po e kuptoj pse në këtë mënyrë është duke u vepruar. E dyta, po e vërej tendencën e kryetarit për t’ju lënë qytetarëve fajin, kinse ata po i mbyllin kanalizimet. Shkoni flisni me qytetarët, të mos i mbyllin kanalizimet atje. E treta, ujë i pijshëm, fort mirë është sqaruar sidomos në debatin e “Jeta në Komunë”, që ishte këtu, ujët e pijes që nuk pihet. Analizat që kanë ardhur prej Institutit del që nuk pihet, kur është bërë ajo analiza, publikojeni, thuajuni qytetarëve po pihet ujët. A po e pinë më së pari punëtorët e Komunës këta ujë? Nuk di pse po hezitoni dhe të sqaroni se nuk pihet”, shtoi anëtar i Merturi.

Haxhi Ibishi, tha së pari tu kisha lutur mos e keqpërdor foltoren, është 10 minuat për shefin e GP për të folur, 5 minuat për secilin. Kam respektuar më tepër se 5 minuta, secilit i kam dhënë mundësinë dhe nga 1 minutë replikë. Më vjen keq më duhet ta them më duhet një trajnim kolegjial juaji. Me krejt respektin për secilin, duhet një trajnim kolegjial profesional për asamblistët. Kur na thonë të huajt ju them se s’ka nevojë se e kanë krijuar këtë përvojë, nuk ka nevojë trajnim, unë po shoh që temave të caktuara në momente të caktuara po dalim jashtë rendit të ditës. Petrit prapë po të jap sqarim punëtorët ndihmës që kanë qenë në shtëpi të shëndetit janë punëtorë të një kompanie private. Nëse dëshironi për debat ne e bëjmë për një seancë tjetër. Po jam korrekt për të gjithë. Nuk dua për të më implikuar tendencën, që ka ndokush tendencë për ngufatjeje të bisedës së lirë këtu, bile përkundrazi kam vërejtje pse ju toleroj aq shumë të gjithëve, duke përfshirë edhe opozitën”, theksoi Kryesuesi.

Sokol Bashota, tha se asnjëherë debati rreth një raporti të tillë nuk ka zgjatur kaq shumë, prandaj edhe nuk e kam llogaritur kohën dhe na ka rastisur kështu që unë me 5-6 drejtorë të kemi një takim urgjent, në sajë të kësaj për të mos ngulfatur fjalën e lirë, për të zhvilluar debatin kisha propozuar që të mbahet një seancë tjetër. Nuk ka problem, edhe nesër mund ta mbajmë. Por na ka qëlluar ky takim, duke menduar që nuk do të zgjatet kaq gjatë, po bëhen veç dy orë që po diskutohet rreth këtij raporti. Të gjitha mundësitë i shterim, nuk ka rëndësi, mund të vazhdojmë një ditë tjetër. Megjithatë qysh të dëshironi mund të vendosim”, theksoi kryetari Bashota.

Haxhi Ibishi, theksoi se kjo është një korrektësi juaji që realisht lejon zhvillim debati, por unë mendoj se secili këshilltar komunal, duke veçuar opozitën, keni debatuar lirshëm dhe për të gjitha temat keni shkelur Rregulloren me vetëdijen time duke ju liru në tolerancë për t’i shfaqur qëndrimet e juaja. “Është jo korrekte, jo kolegjiale, të thuhet se ndokush ka pasur tendencë ngufatjeje. Por profesori Ndue me bashkë sugjerimin tim ka thënë që temat që i kemi debatuar një herë të mos gjejnë vend për herë të dytë brenda të njëjtit muaj ose 35 ditëve. Për mungesën e Skënderit dhe i doktorësh drejtori i Financave sqaroi disa çështje financiare, por ne e kemi pasur Raportin financiar në seancën e kaluar, ku në mënyrë detale të gjithë të pranishmit pozitë-opozitë keni dhënë vërejtjet e juaja, edhe e kemi miratuar kolektivisht. Nuk ka nxitim, askush prej nesh nuk ka dëshirë për të penguar debatin. Bile – bile z. Tunë Dedës dua t’i them si shef i GP të AAK-së, Kryetari me gatishmërinë e vet për debat pranoi kundrejt Rregullores dhe Ligjit për të hyrë si pikë e veçantë debati për shkollën gjegjëse. Ky njëherësh edhe është kryetar i PDK-së. Prandaj unë mendoj që mund të votohet raporti dhe ju kisha lutur, të pranishëm në sallë jemi 26 anëtarë, kush është që të miratohet Raporti i Ekzekutivit për vitin 2015?

Me 14 vota për, 12 kundër, asnjë abstenim, u miratua Raporti i Ekzekutivit për vitin 2015.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për lëshimin në diskutim publik të Projekt-rregullores për ndarjen e bursave për studentë të rregullt të Universiteteve të Republikës së Kosovës.

Haxhi Ibishi, tha se ju e dini që kjo asamble ka marrë vendim në seancën e kaluar për ndarjen nga subvencionet të bursave për studentë të Klinës që studiojnë në Universitetet e Republikës së Kosovës.” Drejtoria gjegjëse me Zyrën ligjore ka hartuar një rregullore për të vendosur në diskutim publik. Këto janë procedura”, theksoi Dr. Ibishi, i cili në vijim hapi debatin.

Vuri në miratim Propozim-vendimin për lëshim në diskutim publik të Projekt-rregullore për studentë të rregullt të Universiteteve të Republikës së Kosovës.

Me 20 vota për, pa kundër, 5 abstenime u miratua propozim-vendimi për lëshim në diskutim publik të Projekt-rregullorja për studentë të rregullt të Universiteteve të Republikës së Kosovës.

Fadil Gashi, tha se me keqardhje po e them, mirëpo me këtë sjellje tuajën po na nxit edhe të flasim, po na nxit për të votuar edhe ashtu siç s’e kemi ndërmend. “Së pari, nuk pate nevojë të nguteni fare për të folur, e dyta, është mirë për të kërkuar falje, sepse nuk kanë nevojë gjithë anëtarët e asamblesë për t’u trajnuar. “Nëse ka nevojë ke edhe ti, por është fyerje. E ke vënë në diskutim një raport, voluminoz, apo edhe mund ta emërtojme si të doni, këta që debatojnë, a e kanë mirë apo nuk e kanë mirë, këta jemi, ne nuk mund të ndërrohem, s’kemi rënë nga hëna as ju, dikush e ka mirë, dikush nuk e ka aq mirë, ti je ai instrumenti që e rregullon këtë çështje. Edhe mos u merr për të madhe njerëzve, por nuk ke të drejtë në asnjë variant për t’i thënë askujt “ke nevojë për t’u trajnuar”. A kanë nevojë për t’u trajnuar apo s’kanë ua ka dhënë ajo votë qysh ju ka dhënë, a jemi të mirë apo të këqij kështu siç kemi ardhur të gjithë si asamble bashkërisht, ashtu e kanë vlerësuar, a jemi të mençur apo të mençur ashtu e kanë vlerësuar, kështu kemi ardhur me një instrument të votës, por në asnjë variant për t’i treguar ndokujt për t’u trajnuar. Edhe Kryetari propozoi, edhe nesër, edhe pasnesër. Pse tash po propozimi pauzë, pse nuk propozove pauza para raportit. Nëse ka tendencë tash po ta them ka prej teje. Pse po del tash pauza kur pati mundësi të jetë para raportit, e propozoi edhe Kryetari, nuk ishte aq tragjike. E tha Kryetari, e kemi kërkuar këtë raport, e kemi respektuar, e keni prurë, çfarë pat këtu? Nuk pati asgjë të keqe, u debatua, lëreni njerëzit të debatojnë. Edhe një po ju them: nuk e keni problem vetëm ju, por e kam pasur edhe unë kur kam qenë kryesues, njerëzit që punojnë e ruajnë me minuta këtë seancë. Kjo është ditë e lirë për këtë seancë për sot, edhe gjithë ata që punojnë e kanë ditë të arsyetuar. Të gjithë e ruajnë këtë seancë një herë në muaj, kjo është një lloj presioni simpatik, “e kemi këtë, e kemi edhe këtë, eja ngutu dhe përfundoje. Sinqerisht kjo nuk është e mirë kjo”, nënvizoi anëtari Gashi.

Sokol Bashota, tha se nuk dua të luaj rolin e avokatit të askujt, por në rregullore 2017/3 ,kam qenë edhe kryesues i Asamblesë në atë kohë ke punuar me një rregullore të asamblesë. Po ashtu është respektuar ajo rregullore po në këtë asamble. Janë caktuar edhe minutazhet, edhe diskutimet, edhe kur flet në emër të grupit. Në qoftë se nuk mjafton ajo kohë kërkojmë një komision tjetër dhe e ndryshojmë rregullore, rrisim minutazhen dhe e bëjmë sa të dëshironi. Por, pa limit nuk ka diskutim. Tregomëni mua, cilat qenkan masat ndëshkuese për një asamblist, apo kur nuk merr vesh, del nga rendi i ditës se nuk e respekton orarin. Gabimet ka bërë kryesuesi se po toleron kohën e caktuar. Të qitet një orë atje dhe ta shihni orën vetë tash e tutje, edhe respektojeni vetë, bëhuni më kolegial, dhe të keni pak respekt për kolegët. Unë e kam prurë raportin, qëllimisht e thashë, nuk kam bërë asnjë ndërhyrje të raportit të drejtorëve. Unë vërejtjet që kam gjetur vetë në raport i diskutoj me BD, po kam dashur ashtu siç është, për arsye se le të jenë koshientë gjithsecili për punën e vet. Prandaj, është një rregullore e kësaj asambleje, vetë e keni bërë, keni mundësi ta ndryshoni vetë. Pastaj edhe Kryesuesin e asamblesë nuk e qitni në këto telashe me ju sepse po del që ka diçka personale. Ne e masim kohën edhe të pozitës dhe të opozitës dhe shikojmë si po del llogaria. Bile –bile rrallë herë ka ndodhur për të gjetur element brenda pozitës që e kritikon opozitën. Po bëhen gati 9 vjet si kryetar i Komunës në asnjë mbledhje me asamblistët e PDK-së nuk kam shkuar për rend të ditës të asamblesë. Përderisa nuk kam mundur të vi për të

biseduar as me ju nuk kam shkuar as me këta, edhe pse jam kryetar i këtij subjekti. Ajo është një rregullore, që realisht foltorja në të shumtën e rasteve po keqpërdoret. Këtu nuk është qytetari për ta vlerësuar këtë punën tonë që po e bëjmë këtu, por ne vetëm po thumbohemi me njëri-tjetrin për qëllime të caktuara, krejt ky debat që po bëhet qohesh dhe voton kundër. Po që se ke gjetur elemente pas sqarimeve tona për ta bindur veten për ta votuar, kisha bërë zhurmë 3 ditë, kisha kërkuar 3 ditë afat në fund për të nxjerrë diçka. Ne po bëjmë debat për diçka kanë për t'u bërë. Ne këtë raport kurrë se kemi votuar, asnjëherë, as nuk e kemi diskutuar, por është njoftim i Kryetarit për raportin njëvjeçar, por e kemi bërë me qëllimin më të mirë, për ta sjellë në asamble, për ta diskutuar, ka qenë kërkesa e vetë Fadilit për t'ju dhënë mundësitë për të diskutuar, dhe e kemi bërë, edhe kemi për ta bërë edhe në të ardhmen, nuk ka asnjë problem, por minutazhet ju kisha lutur për të mos na qitur në lajthitje respektojeni sipas rregullores”, konstatoi kryetar Bashota.

Haxhi Ibishi, tha se desha Fadilit dy gjera për t'ia thënë, jo në personalen as si kryetar i LDK-së, askush nga ne nuk ka tendencë për ta lënduar askënd në komunikim, askush prej nesh nuk ka tendencë për të ngulfatur debatin. “Unë kur flas nuk kam thënë “keni”, por kam thënë kemi”, është dallim në mes të shprehjes “keni” dhe “kemi”, duke përfshirë edhe veten me bashkpartiakët. Me vetë faktin që nuk po respektohet diçka çka kemi miratuar në Kuvend, qoftë rendin e ditës me propozim të këshilltarit e me miratim tuajin e zgjeruam, atëherë nuk ka ndonjë tendencë që ne të ndërpresim seancën, por vetë fakti që do të jetë debati shtesë, pika të cilën e vendosëm, i duhej një pushim kësaj asambleje. Nuk ka pasur as tendencë personale timen as nuk kam ndonjë punë tjetër sot përpos kësaj pune. Dua të them edhe diçka, nuk kam asnjë tutor në vlerësimin e punës sime dhe nuk i përgjigjem asnjë skeme përpos asaj që jam i bindur vetë personalisht. Por kur bindem diçka dhe e shoh kur një koleg është në devijim me atë që jem i përcaktuar për debat, është logjike për ti thënë nuk je në rregull, më tepër se kolegjiale, se sa për sugjerim. E për respekt të kohës dhe opinion është organizata Koha që e ka parë minutazhen dua për të qenë korrekt. Arben Liman i ka diskutuar prej minutës 10-37 deri në minutën 10-48, 11 minuta, Skënder Merturi ka diskutuar prej orës 10-59 minuta deri 11-09 minuta. Prandaj, domethënë, kam qenë korrekt në këtë drejtim dhe nuk dua askush të implikojë që ka pasur tendencë për ngulfatje të debatit. Unë këtu jam vetëm një koordinator dhe nuk pretendoj veten për të qenë mbi ju. Por edhe e respektova kërkesën e kryetarit që tha se kemi një takim me 5 drejtorë, nëse dëshironi për ta vazhduar mund të vazhdojmë, nëse jo shkojmë në pushim, qysh ju të çmoni shumica. Unë propozova për të shkuar gjysmë ore në pushim, qoftë se nuk ka propozim tjetër shkojmë dhe vazhdojmë, si të dëshironi”, ka pohuar kryesuesi Ibishi.

Skënder Merturi, tha se unë nuk po mundem për të kuptuar tendencën e pushtit për të ndalur këtë debat. “Tendenca, “mos fol, mos fol”, “mos u zgjat shumë”, “mos dil jashtë rendit të ditës”, “mos t'i përsërisim fjalët” etj., etj., për mua është e papranueshme, se kjo logjikë është e dëmshme, nëse keni për të shkuar të drekoni, tregonani edhe dilni, por jo në këtë mënyrë. Një herë në vite e kemi këtë raport këtu, një herë në vit vjen Kryetari këtu, edhe mos të debatojmë nuk ka logjikë Unë i shoh disa kolegë të pozitës se si flasin, “ndale mos u zgjat”, e kjo tendencë e ndaljes së zërit opozitar nuk është e mire Ky raport është për t'u diskutuar, edhe duhet të debatojmë sa të kemi nevojë, se pushteti këtë e do, që ne ta mbyllim gojën, por ta lejoni debatin”, ka theksuar anëtar Merturi.

Kryesuesi kërkoi një pauzë në kohëzgjatje prej 30 minutave. Pas pauzës 30 minuta u procedua me vazhdimin e seancës.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për subvencionimin e klubeve sportive “Dukagjini” në Klinë (Ref. drejtoresha e DKRS).

Kryesuesi Dr. Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën e barti te drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, znj. Kristina Lazri.

Kristina Lazri (Drejtoreshë e DKRS), foli rreth çështjes në debat. “Më herët KPF-së i kam bërë kërkesë për subvencionimin e klubeve sportive “Dukagjini” në Komunën e Klinës. Klubet këto që janë të licencuara dhe kanë të drejtë në garimin në Ligën e Parë të Kosovës dhe Superligën e Kosovës. Dhe duke u bazuar në

Rregulloren për Subvensione dhe Transvere, e cila rregullore është aprovuar në këtë AK, kërkoj mbështetjen e juaj, pas një debati që do ta bëjmë, që t'i mbështesim këto klube me këto shuma që ne i kemi cekur, apo edhe në bazë të kërkesave që i kanë bërë edhe vetë klubet", theksoi drejtoresha Lazri.

Kryesuesi hapi debatin.

Haxhi Ibishi, tha se në KPF kemi qenë të gjithë në dakord që ky propozim të përkrahet.

Tunë Dedaj, tha se ne si Grup i asamblistëve të AAK-së e përkrahim, por është një kërkesë jona që kjo shumë të rritet, kështu që Klubit të futbollit t'i jepen 25 mijë euro, ndër këtyre dy klubeve tjera edhe të futbollit për femra, edhe të volejbollit t'u jepen nga 4 mijë euro.

Fadil Gashi, tha se ne e kemi biseduar edhe në KPF. "Në Komitet për Politikë dhe Financa" nuk jemi dakorduar të ketë rritje vetëm te klubi i futbollit, por po që se ekzistojnë mundësitë të ndihmohen të gjitha klubet e "Dukagjinit. Në KPF kam kërkuar, po e përsëris edhe këtu, pagesa e referëve etj., ato janë të përcaktuara, mirëpo te stimulimi i lojtarëve, nëse stimulohen lojtarët e futbollit të KF "Dukagjini", të stimulohen edhe lojtarët e këtyre dy klubeve të tjera sportive. Kjo është kërkesë imja në këtë rast, edhe të shikohen mundësitë t'u ndihmohen edhe atyre dy klubeve dhe të mos diskriminohen klubet e njëjta, me emërtim të njëjtë, edhe për t'ju dhënë një sinjal që edhe ne si Kuvend, si Komunë jemi në përkrahje të tyre, por jo për dikë nënë e për dikë njerë. Edhe një herë po e përsëris me keqardhje: nëse për KF "Dukagjini" ka kush të flas, për ato ku s'ka kush të flas të kenë një trajtim tjetër", ka theksuar anëtarë Gashi.

Ramush Agushi, tha se edhe Fadili, e tha edhe Tuna, ne e kemi diskutuar në KPF dhe ne kemi dhënë një propozim për Kuvend. "Edhe unë e përkrahi që mundësisht po që se ekzistojnë mundësitë të rritet kjo shumë, edhe jam i sigurt që stimulohen edhe klubet e futbollit të femrave "Dukagjini", edhe klubi i volejbollit, stimulohen nga pak edhe lojtarët po ashtu nga pak. Nuk janë shuma sikur meshkujt, por diçka edhe atyre u jepet me mundësi të buxhetit që ekziston, sepse edhe ato kanë shpenzime për të ardhur deri aty. Kemi biseduar edhe me drejtorin e klubit të futbollit të femrave, po që se ofrohen mundësitë për një stimulim sado modest. Prandaj tek KF të femrave me mundësi të rritet kjo shumë dhe propozimi im është të shkohet në 5 mijë", tha anëtarë Agushi.

Vlora Tafilaj, tha se po më vjen mirë që paskeni menduar për sportin, nuk di kjo ndarje sa është korrekte, dikujt i ndahet shuma prej 20 mijë euro, ndërsa dikujt 2 mijë euro, prandaj mendoj se është një diferencë e kësaj shume të ndarjes bajagi e madhe, mirëpo këta të KF "Dukagjini" janë për t'i stimuluar shumë, prej 2014 deri 2015, 48 për qind të subvencioneve pothuaj u janë dedikuar KF "Dukagjini". Kështu që, mendoni pak edhe për klubin e volejbollit edhe për klubin e futbollit të femrave", pohoi anëtarja Tafilaj.

Kristina Lazri, tha se ne jemi nisur në bazë të asaj që sa kemi mundësi sivjet të subvencionojmë, do të thotë e kemi llogaritur. "Për më shumë informacion ndoshta edhe Kryetari do t'ju flas. Mirëpo, edhe unë jam për t'ju rritur buxhetin dy klubeve të femrave, unë për dëshirë ju bëj edhe këtyre nga 10 mijë euro, mirëpo duke llogaritur që sivjet ia kemi nisur vonë, do të thotë është për herë të parë, edhe për herë të parë të subvencionohet një klub sportiv me shumën 3 mijë euro, besoni që nuk është pak. Në asnjë komunë nuk i subvencionojnë më shumë. KF "Dukagjini i meshkujve është në një fazë shumë të mirë të sukseseve, që po pretendon për të shkuar edhe në Superligën e Kosovës, për këtë arsye, plus shpenzimet e Federatës janë shumë më të mëdha, futbollit i femrave nuk ka shpenzime, i ka gratis, volejbollit po ashtu paguhet, 800 euro prej këtyre vetëm për një sezon shkojnë do të thotë pagesa të Federatës, referim etj. Kështu që si do të vendosni për mua do të ishte kënaqësi", shtoi drejtoresha Lazri.

Haxhi Ibishi, tha se po e shoh në dakordimi për t'u ndihmuar gjitha klubeve të "Dukagjinit". "Është e vërtetë që edhe në KPF e kemi dhënë vizën e gjelbër, është biseduar të shikohen mundësitë a mundet pak më shumë të grupi i femrave, qoftë në futboll, qoftë në volejbol, a mundet Kryetari dhe Ekzekutivi për të pasur parasysh. Për arsye që për futboll të gjithë e dimë thjeshtë është klub që na nderon momentalisht, edhe është përmes buxhetit

të Kosovës është mbajtur në këto 7-8 vitet e fundit. Prandaj ka bukur shumë shpenzime, janë shpenzime marramendëse, në krahasim me sportet tjera, derisa të miratohet Ligji mbi financimin e sportit, sigurisht që i mbetet Komunës, kështu qysh e kemi shtyrë deri me tash për t'i shtyrë klubet edhe në vijimësi. Po e shoh që secili prej nesh vetëm i lyp kufijtë buxhetorë, ndoshta Kryetari na kishte ndihmuar në këtë rast", shtoi Kryesuesi Ibishi.

Sokol Bashota, theksoi se edhe në Ligjin mbi sportet është që edhe Komuna për t'u ndihmuar sportet në përgjithësi, por t'ju them të drejtën asnjëherë nuk na janë caktuar format dhe mënyrat sa cilin sport për ta ndihmuar. "Te kapitelet nuk bën, te subvencionet po ashtu nuk ka mundësi për t'i rritur, dhe thjeshtë këtu është një konflikt, përkatësisht vakum ligjore, ose si ta quaj, dhe jo si rezultat e ndokujt tjetër mirëpo edhe kështu ne jemi trajtuar në organet e hetuesisë, pikërisht për këtë arsye thjeshtë një raport i auditorit i cili nuk ka ditur për ta dhënë përgjigje. I kemi lënë ato 50 mijë euro që janë për ngritje të kapaciteteve sportive, dhe thonë "jo tash nuk bën për t'i dhënë!" Është shkresë që nuk bën. Edhe tash e dini që vullnetarisht i kam pasur shkurtuar subvencionet e mia nga 85 mijë diku këtë vit në 65 mijë euro, ku përfshihen klubet e "Dukagjini", tash merremi vesh për t'i dhënë, edhe pse me Rregulloren për ndarjen e subvencioneve më lejojnë mundësitë deri në 2 mijë euro për t'i dhënë vetë, tek e fundit më duhet ballafaquar prapë me asamble kur, qysh, tek, si, që vendos asambleja për gjitha ndarjet, që për të gjitha ndarjet e subvencioneve ka ligjshmëri dhe ka arsyeshmëri. Por do t'ju tregoj tash ku jemi: diku rreth, se di saktë se dy zyrtarë janë në pushim, të cilët kishin pasur mundësi të japin përgjigje pak më adekuate, sa kanë shkuar deri në këtë muaj, ndoshta ka mbetur edhe ndonjë borxh nga viti i kaluar, dhe është e palogjikshme një punëtor i Komunës, që fatkeqësisht kemi 2 raste që janë ndarë nga jeta, por ka edhe të tjerë të prekur me kancer dhe më sëmundje të tjera, si punëtorë të administratës iu kemi ndihmuar, edhe këtu auditori thotë "nuk bën për të ndihmuar punëtorin e administratës!" Merreni me mend deri në çfarë shkalle shkon "humanizmi", por unë megjithatë ju kam treguar dhe ju kam thënë se po që se prapë paraqitet nevoja do të vazhdojë me sjellje të tilla, se një punëtor i komunës për 300 euro që i merr subvencione nuk është shumë e madhe. I kemi këto raste. Kemi festivalin "Mujë Krasniqi", që patjetër duhet për t'i ndarë 15 mijë euro. Kemi "Orën e Tahir Deskut", kemi tash "Ditën e të Zhdukurve", tash bursat e studentëve, 10 mijë, kemi Ditën e Çlirimit, kemi Festivalin, 28 Nëntorin, edhe këto rastet shëndetësore, që prej tash për të mbetur pa asnjë cent do të jeni të sigurt se te asnjë kategori nuk kemi mundësi për të prekur për çfarëdo rasti të jetë eventual që ka mundësi për të na u paraqitur. Dhe kam dashur 10 mijë euro për t'i lënë të lira për këto raste dhe pastaj të shikojë se çfarë mund të mbetet për sportin. Domethënë 15 i kemi të Festivalit, 10 për bursat e studentëve, 10 mijë nëse veç i lëmë për rastet shëndetësore që i kemi të këtij viti edhe 9 muaj, domethënë 35 mijë euro janë këto festat që i kemi, pa ndonjë rast, pa ndonjë vizitë që do të kemi, ndonjë vizite të ndonjë delegacioni, ministror, qeveritar apo të ndonjë vizite të ndokujt jashtë vendi, pak këto, se fundmi kemi mundësi t'i mbulojmë në forma të ndryshme, festat fetare, që i kemi edhe në kalendar, të cilat mbulohen krejt prej subvencioneve. Tash duhet për të ditur, se çfarë po bëjmë? Klubi "Dukagjini" është në rrugë të mbarë, ka shikueshmëri shumë të madhe, e ka krijuar tashmë traditën, uroj që të bëjnë edhe këto sportet tjera, nëse gjejmë forma më adekuate, më të mira për vitin e ardhshëm, ne do të hulumtojmë se për sport jo 20 mijë e 30 mijë, por edhe 100 mijë euro nëse vendos asambleja dhe gjejmë forma si t'i ndajmë këto kategori, unë për vete jam i gatshëm për të ndihmuar, për arsye se këta të rinj dhe këto të reja, më mirë është për t'u orientuar rreth këtyre sporteve, se sa për t'u orientuar në rrugë të tjera. Por ndoshta-ndoshta për klubin, 20 mijë euro kanë qenë të mjaftueshme, e di që nuk kanë për të mundur për t'ia dalë deri në fund, por duhet gjetur forma tjera si për të mbuluar shpenzimet; 40 mijë euro për këto dy klubet, për fillim, besoj se vajzat i kanë edhe disa benificione tjera, qoftë nga Federata i kanë, nuk paguajnë as referim etj. Kështu që për mua qysh të dëshironi t'i ndani, mirëpo nëse nuk i lëmë për festivalin 20 mijë gjithqysh, 10 mijë veç janë ndarë, zotuar gjithqysh, 10 mijë tash për bursa, dhe unë kisha menduar për t'i lënë për këto raste për nevoja të ndryshme që kanë qytetarët, që nesër për të na i sjellë kërkesat janë enorme për këto raste që kërkojnë trajtim, edhe askujt nuk ju kemi dhënë deri me sot mbi 500 euro, shumica janë 200-300, janë mjete shumë modeste në raport me çfarë ilaçesh i blejnë, sidomos ata që trajtohen me kancer. Ne kemi pasur punëtorë të Komunës që është keq për ta potencuar dhe të cilët fatkeqësisht janë ndarë nga jeta dhe të cilëve nuk kemi pasur mundësi t'u ndihmojmë më tepër se sa në këtë

shumë që potencuam. Domethënë 35 mijë duhet lënë për këto destinacione, të tjerat për t'i ndarë për sport", theksoi kryetari Bashota.

Tunë Dedaj, tha se vetë kam qenë në Kryesi të Klubit të futbollit dhe e di për shpenzimet që bëhen aty, do të thotë janë shpenzime të pakrahasueshme dhe këtë shumë që është paraparë për t'ju dhënë është shumë e vogël që nuk i mbulon as për së afërmi nevojat, edhe pajtohem me ju Kryetar që thoni edhe 100 mijë euro po t'u ndahen në vit për sportet nuk është shumë, por është pak, se është mirë që rininë e orientojmë në sport, në kulturë dhe rini. Pak më preku drejtoresha, në mundoheshim për t'u dhënë para pak më shumë, ndërsa kjo thoshte, "jo më pak na jepni!"- theksoi anëtari Dedaj.

Sokol Bashota, tha se mund t'u mbetem borxh dy firmave që kanë klubin "Dukagjini", domethënë dukshëm ju kanë ndihmuar, "Albpetrolin", edhe "Nora-Bujari", ka ndihmuar me 3500 euro ka ndihmuar vajzat në volejboll. Vitin e ardhshëm do të hyjë Ligji për sport do të hyjë në fuqi, mendoj që është dashur të hyjë në fuqi, pastaj kam për të vrapuar firmat për të ndihmuar se do të kenë edhe është në interesin e tyre", theksoi Kryetari.

Kristina Lazri, tha se më duhet inkuadruar në diskutim se po që se klubet do ta marrin procesverbalin do të më mbesin në qafë, se nuk po do për të na përkrahur. "Një fjalë e urtë thotë: "Shtrijë hapat sa e ke jorganin", ne që një muaj ose dy kemi diskutuar çështjen e subvencionimit. Unë jam nisë nga ajo se e di sa ka buxhet. E dimë sa kemi mundësi buxhetore, jam për t'i rritur këto 2 mijë, e thashë edhe më herët, por jo të shkohet në shumat 5 mijë e 6 mijë, sepse nuk kemi mundësi. Në atë aspekt e thashë, ndoshta u keqkuptova, se unë për dëshirë klubin e vazhdoj, përkatësisht dy klubet, kisha dashur të subvencionohen, sepse mendoj se duhet subvencionuar këto klube pak më shumë, mirëpo është viti i parë, do të thotë se kemi pasur nga pak edhe donacione, mirëpo sezonin vjeshtor që kemi pasur vjet, domethënë volejbollin e ka subvencionuar, përkatësisht përkrahur Bujar Morina – "Nora", mirëpo tash ky sezoni pranveror, edhe vjeshtori tash që vjen, do të thotë duhet nisur prej përkrahjes së Komunës, derisa nuk shkon në lexim të dytë Ligji për subvencionimin e klubeve", nënvizoi drejtoresha Lazri.

Haxhi Ibishi, tha se unë e vërejtja që Kryetari avancoi në mundësitë, përkatësisht në kapacitetet buxhetore që ka Komuna, edhe Kryetari dha një propozim shtesë krahas atij materiali që kemi. "Sa unë kuptova, Kryetari tha për KF "Dukagjini" të mbesin 20 mijë dhe për dy klubet e femrave "Dukagjini", vajzat në futboll dhe vajzat në volejboll të ngritën nga 1 mijë euro, domethënë nga 3 mijë euro subvencione. Domethënë është një propozim i ri", shtoi Kryesuesi

Ramush Agushi, tha se Klubit të futbollit të femrave dhe klubit të volejbollit po ashtu të femrave, kanë një dallim në shpenzime, dhe propozoj që 1 mijë euro t'u jepen më shumë KF të femrave se sa të volejbollit, vetëm aty, theksoi anëtari Agushi.

Kristina Lazri, tha që javën që të vjen do të thotë 800 euro kanë për t'ju paguar, domethënë kur të lëshohen këto mjete, për sezonin pranveror 800 euro kanë për t'ju paguar Federatës, 800 euro janë për sezonin vjeshtor, po bëjnë 1600 euro, prej këtyre tash sa po mbesin, duan ato ta hanë një drekë, t'ju jepen 10 euro sikur të tjerëve. "Po flas për volejboll. Për t'ju dhënë 3 mijë euro nuk besoj që është pak për sivjet", shtoi ajo.

Ramush Agushi, tha se unë nuk e kontestoi atë që thoni, por derisa Kryetari po thotë 3 mijë kënde, 3 mijë andej, po them te klubi i femrave në futboll për ta rritur 1 mijë më tepër, jo t'u hiqen atyre të volejbollit. "Ju i keni kërkuar 2 mijë, po ju bëhen 3 mijë, e di që në bazë të shpenzimeve që i kanë femrat në futboll janë shpenzime më të mëdha të futbollit se sa te volejbollit. Po flas në bazë të shpenzimeve, asgjë tjetër", pohoi anëtari Agushi.

Haxhi Ibishi, tha se kemi variantin e propozuar nga Kryetari.

Kryetari Bashota, edhe një herë sqaroi çështjen e subvencionimeve. "Të jeni të sigurt për njerëzit që vinë më çfarë atomizmi vinë në Komunë për t'u ndihmuar, duke mos me i ditë mundësitë buxhetore çfarë i ka Komuna, edhe kur ndahen 300-500 euro është mjaft, theksoi Kryetari.

Fadil Gashi, tha se edhe në KPF, jemi rezervuar për të potencuar shuma. “Në kërkesën dhe parallogaritjen që e ka prurë KF “Dukagjini”, i futbollit, i meshkujve, e kam fjalën te kualifikimi për 4 muaj i pagesës së lojtarëve për kampionatin pranveror, edhe tash del 4 herë 4.500 euro del 18 mijë euro. Propozimi im është, nëse stimulohen lojtarët, stimulimi të jetë i barabartë. Ne e dimë që klub i volejbollit, futbollit të femrave paska deri 9 lojtarë aty, mund edhe 10 i futbollit, i meshkujve janë 22, apo 24, kështu edhe vetë ata janë të reduktuar. Por stimulimin propozoj ta kenë të barabartë. Unë nuk po caktoj te jetë 3 mijë apo 4 mijë, 5 mijë, ndoshta dalin 2 mijë, ne akoma nuk e kemi qitur lapsin aty, sepse këto shpenzime tjera një pjesë nuk po e dimë se ato lirohen, pjesa tjetër i paguan Komuna, çka duhet, sikurse ju paguan klubeve tjera, vetëm te stimulimi i lojtarëve këtë ta keni parasysh. Nuk ka asgjë tjetër, krejt këto referim etj., te “Dukagjini” nuk i kontestojmë, nuk e kontestojmë as “Dukagjinin”. Bile përkundrazi ne më herët kemi kërkuar, është mirë të kihet kujdes, të shkohet në Federatë dhe për t’i shlyer themeluesin, sepse të Federatës akoma e thërrasin Arbenin si themelues. Është mirë Komuna për t’i kryer këto procedura dhe për t’i shlyer dhe t’ju tregohet se janë ndërruar ato strukturat. Mirëpo, duhet për të pasur shkresat e Komunës, apo të drejtorisë. Nuk jemi duke kundërshtuar as këtë, por a i kemi ne mundësitë, këtu po thuhet për kampionatin pranveror, ndërsa për kampionatin vjeshtor? Ose, a kemi mundësi ta gjejmë një zgjidhje deri në rishikim të buxhetit në qershor, pastaj t’i shikojmë mundësitë buxhetore, këto klube janë këtu në Klinë dhe të stimulohen sa do të kemi mundësi. Kjo është e imja, nuk është rob i shumës”, konstatoi anëtarë Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se edhe Kryetari po ka propozim konkret: po shkojmë 20 mijë për KF “Dukagjini” për meshkuj, 3 mijë për volejbol femrave dhe 4 mijë për futboll të femrave. Domethënë është propozimi i Kryetarit. Kush është për këtë propozim? Të pranishëm jemi 21 anëtarë”.

Me vota unanime (21) u miratua propozimi.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi i Vendimit për miratim të Planit Rregullues të Hollësishëm të Klinës – për harmonizim me Ligjin për Planifikimin Hapësinor, Nr. 04/174 (Ref. Drejtoria e Urbanizmit).

Haxhi Ibishi, tha se e sqaroi edhe Kryetari është një defekt teknik, që duhet të hiqet fjala “ish”, edhe ne me Zyrën ligjore para Asamblesë Komunale këtu edhe me Grishën, si përfaqësuese e Shërbimit të Kuvendit, kemi marrë një shkresë që të obligohet Drejtoria e Urbanizmit me Shërbimin e Kuvendit dhe Zyrën ligjore dhe të konsultohen me Komisionin përkatës në nivel të Ministrisë të Planifikimit Hapësinor për korrigjimin e Vendimit të miratuar në këtë AK. Por, neve na duhet një vendim plotësues për miratimin e rekomandimit të Ministrisë Pushtetit dhe Administrimit Lokal konform Vendimit të Komisionit përkatës, që na është drejtuar me një shkresë neve”, shtoi kryesuesi Dr. Ibishi, i cili në vijim hapi debatin dhe çështjes tematike. “Në hartim mendoj që është gabim në formulimin e Vendimit. Pjesa “ish”, në aspektin teknik është e shkruara dhe ata na kanë sugjeruar që kjo pjesë e ish-Vendimit është hequr pjesa “ish” e Vendimit, shërbimi ynë kur e ka shkruar këtë Vendim”, sqaroi Kryesuesi.

Ali Shala, sqaroi çështjen, i cili mes tjerash konstatoi se si ko incidencë duhet për ta cekur se prej vitit 2003 e më vonë kemi Ligjin e ri për Planifikimin Hapësinor, i cili në tekstin e vet, përveç ndryshimeve tjera e ka bërë edhe ndryshimin e titullimit. “Në vend të Ligjit të mëparshëm që e ka quajtur, Plani Detal Urbanistik, ose Detal Urban, tash Ligji i ri për këtë lloji të planit thotë: “Plani Rregullues i Hollësishëm”. Në kuptim të kësaj dhe keqpërdorim edhe të përdorimit të nocionit që kemi pasur më herët ne tash kemi rënë në kontradikta edhe në gabime që më tepër janë të natyrës tekniko-juridike, por për t’i shikuar realisht ato kanë pasoja edhe në zbatimin praktik. Në kuadër të rekomandimeve që i kemi marrë edhe prej Ministrisë, thuhet se Vendimi për miratimin e PRRH duhet për të qenë në harmoni përpos Ligjit të ri për Planifikim Hapësinor edhe me dy Udhëzime të cilat janë të fundit, përkatësisht të vitit 2015. Në kuadër të kësaj dhe në krejt ecuritë procedurale që kemi ndërmarrë si AK unë kam menduar edhe në konsultim me resorët tjerë që për ta nxjerrë tekstin definitiv të Vendimit duhet edhe një konsultim me Ministrinë përkatëse, përkatësisht Komisionin Ndërmnistror se çfarë mendojnë ata definitivisht për të hequr ose për të shtuar në vendimin e tillë përpos fjalës “ish”, që e kemi cekur në hyrje të Vendimit të mëparshëm dhe ata e kanë trajtuar si gabim teknik. Dua të the, PRRH duhet për të qenë në harmoni

me PZHK, të cilin e kemi miratuar, mirëpo akoma nuk na ka ardhur konfirmimi i ligjshmërisë, edhe pse gjitha afatet e mundshme ligjore kanë kaluar, as Ministria nuk ka vepruar së paku një letër konfirmuese të na dërgojë. Ne si Komunës, si pushtet lokal jemi duke vepruar me at plan. Sipas informacioneve telefonike që ka pasur Shërbimi i Kuvendit ata kanë thënë se PZHK ka kaluar, domethënë është vlerësuar ligjshmëria. Por, ne jemi zyrtarë që punojmë me letra të na konfirmohet, jo përmes bisedave telefonike. E dyta, PRRH duhet të jetë në harmoni edhe me Hartën zonale të Komunës. Këto dy dokumente i paraprijnë këtij. Prandaj në kuptim me këto që po i them, ka qenë mirë që edhe përfaqësuesit të Shërbimit të Kuvendit, të Urbanizmit, drejtorin e Urbanizmit, edhe unë me ta për të shkuar për t'u konsultuar edhe një herë me Ministrinë përkatëse. Ose së paku këto ndryshime qysh na i konfirmojnë ata, ne sot kemi vepruar në kuadër të afatit ligjor 30-ditorë që jemi të obliguar për ta bërë rishqyrtimin e Vendimit. Është e AK, e juaja që të vendosni si të veprohet. Unë kisha për të pasur propozim, që këto rekomandime të miratohen, resorët përkatës të shkojnë për t'u konsultuar dhe për ta arritur tekstin final të korrigjuar të Vendimit të Planit Rregullues Hapësinor", konstatoi zyrtari Shala.

Rasim Millaku, tha se u përpjeka për të dëgjuar, si laik i kësaj fushe, nga ZL kisha kërkuar sqarim, nëse prapë marrim vendim për të ecur tutje, e prapë për të përmirësuar, a është e sigurt Zyra ligjore që nuk na kthen mbrapa si Komision Ndërmnistror. "Sepse, shtoi anëtari Millaku, u tha këtu disa udhëzime, zhvillime, domethënë Harta zonale, të gjitha këto janë ose s'janë dhe nëse marrim këtë vendim a kthehemi prapë mbrapa. Domethënë ZL a ka mundësi të na sqarojë, sepse ne jemi laikë, së paku në si asamblastë nuk jemi profesionistë të kësaj lëmie", vlerësoi anëtari Millaku.

Ali Shala, sqaroi çështjen e kërkuar nga anëtari Millaku. "Në asamblenë e sotme ishte propozimi që të miratohet rekomandimi, se edhe ashtu ligjërisht dhe juridikisht ne jashtë këtyre rekomandimeve nuk kemi mundësi më të ndërmarrim për të miratuar kurrfarë vendimit tjetër. Prandaj në këtë kuptim për të lënë hapësirë përfaqësuesve të Komunës që pas miratimit të këtyre rekomandimeve, edhe në konsultim me Komisionin Ndërmnistror, të arrijë teksti i Vendimit. Domethënë, se asgjë çfarë thotë Komisioni Ndërmnistror, edhe jashtë rekomandimeve që sot i keni para jush ne nuk guxojmë t'i vëmë në letër, se edhe ashtu nuk na konfirmohet ligjshmëria, mendoj që është veprim procedural", sqaroi zyrtari Shala.

Skënder Merturi, tha se për shkak të këtyre paqartësive unë personalisht, nuk është hera e parë që kemi kështu paqartësish, prandaj vota ime do të jetë abstenim.

Fadil Gashi, tha se unë jo rastësisht në fillim propozova për ta hequr, ndoshta kishte qenë mirë ashtu si po propozoni, edhe ju mu duk, edhe ZL, për të qenë ZL, Urbanizmi të shkojnë për të komunikuar me këtë komision, sepse realisht çfarëdo vendimi që marrim ne nuk i ndihmojmë këtij vendimi sot. "Sepse ky është duke kërkuar me ligj, i ka përmendur nenet me të cilët duhet harmonizuar. Fjalën harmonizim është duke e kërkuar. Ai e ka kërkuar nuk është punë e vullnetit a po dëshirojmë ne. Ne jemi duke e pranuar dhe nuk është hera e parë dhe nuk mund ta kontestojmë këtë. Komisioni po thotë konstatoi si në vijim. Po krejt në fund, nëse i referohemi dhe pasusit të fundit thotë: "Komisioni rekomandon që Vendimi të kthehet në rishqyrtim, (fjala është për vendimin tonë), edhe të ndërmerren veprime për harmonizim me Ligjin, (kaq, kaq...) për Planifikim Hapësinor". Më mirë do të kishte qenë për t'u pajtuar ne, le të shkojnë këta të gjithë, le të kontaktojnë me komisionin edhe le ta kërkojnë saktë edhe ata çfarë po kërkojnë, jo ne të mbesim të vjerrur në çdo seancë ata duke në çuar shkresa "u pranua", "u anulua...", theksoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, theksoi se edhe ne në këtë drejtim e kemi hartuar tekstin me konsultën e Zyrën ligjore që do t'ju lexoj dhe do t'ju ofroj juve për votim. "E kemi miratuar kështu: "Miratim, me rekomandimin e Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe të Komisionit përkatës, rreth shqyrtimit të Vendimit për miratimin e PRRH të Komunës së Klinës".

Domethënë ne e rekomandojmë miratimin edhe pastaj obligohet Drejtorinë e Urbanizmit, së bashkë me SHK dhe ZL, krejtësisht të qartësojë këtë problematikë, që të mos ketë më dilema. Domethënë, kjo është ajo poenta edhe e kësaj pike që kemi përfshirë në rend të ditës. Atëherë a po pajtohemi që të votojmë. Të pranishëm jemi

21 anëtarë. Kush është të miratojmë rekomandimin e Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal dhe të Komisionit përkatës rreth rishqyrtimit të Vendimit për miratimin e PRRH të Komunës së Klinës?

Me 20 vota për 1 abstenim, kundër s'ka miratohet rekomandimi i MAPL dhe të Komisionit gjegjës.

Pika e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për zëvendësimin e një anëtari të Komitetit për Urbanizëm, Ekonomik dhe Zhvillim (pas tërheqjes së Ali Sylës).

Haxhi Ibishi, tha se Ali Sylë në këtë komision ka përfaqësuar “Vetëvendosjen”, dhe meqenëse këtë praktikë çelësin e kemi zbatuar vijimësi, kërkoj që përfaqësuesi i “Vetëvendosjes” të na jep një propozim. “Z. Ali Sylë ka fituar statusin e veteranit të luftës së UÇK-së dhe ka kërkuar të lriohet nga ky komision”, sqaroi Kryesuesi.

Skënder Merturi, tha se çështja veç e sqarua nga Kryesuesi, në vend të Ali Sylës propozoj Destan Rudin.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Me 20 vota për 1 kundër, u miratua propozimi që z. Destan Rudi të jetë anëtar i Komisionit për Urbanizëm, Ekonomi dhe Zhvillim, në vend të Ali Sylës.

Pika e tetë: Debati rreth gjendjes në shkollën fillore “Atë Gjergj Fishta” në Jagodë.

Kryesuesi foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën e barti te sponsoruesi i pikës së rendit të ditës, anëtari Pal Berisha.

Pal Berisha, tha se unë e kam ngritur si çështje të cilën kërkoj nga drejtori i DKA-së të jep përgjigje se çfarë është duke ndodhur në shkollën e Jagodës. “Dhe, ndërsa unë thosha se atje bojkotohet ora e gjuhës shqipe, mund duk, ju kërkoj ndjesë po që se e kam dëgjuar gabimisht, mu duk se drejtori i DKA-së thoshte “s’është e vërtetë”. Unë, pra kërkoj sqarime çka në të vërtetë është duke ndodhur në shkollën e Jagodës”, tha anëtari Berisha.

Hajdin Morina, drejtor i DKA-së, sqaroi çështjen. “Do të mundohem t’u përgjigjem pyetjeve që ishin pak edhe para Jagodës, mirëpo më shumë Jagoda. Së pari falënderoi Palin, deputetin dhe Kryetarin, që e futën në rend të ditës, ne nuk e kemi ndërmend të vijmë me probleme, se shkolla nuk është imja, por e gjithë Klinës, është e Republikës dhe e gjithë qytetarëve. Dhe pa hyrë menjëherë po përgjigjem me shumë fjalë të mira Palit, që nuk e kam thënë “nuk është e vërtetë”, po ju kam përgjigjur Ndue Shabanajt, “nuk është që është bojkotuar puna në Jagodë, por vetëm ora e gjuhës shqipe, jo tjerat”. Domethënë shkolla nuk ka bojkot të mësimit, por kanë vetëm orët e gjuhës shqipe, prej datës 23 mars deri me sot. Në kontakt me drejtorin e shkollës, prej datës 23 në mbrëmje, se isha diku në konferencë të arsimit edhe drejtori me tha që jam në kontakt me prindër, besoj që zgjidhet problemi, por disa prindër nuk më hapin fare telefonin. Unë dhe ai do të jemi në kontakt, jemi për zgjidhje të atij problemi, edhe besoj se do ta kemi ndihmën e prindërve, dhe besoj që është një problem që nuk lidhet me ligjin as me bojkotin që duhet të bëjnë fëmijëve tanë që ata ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese për mësim, s’po them për të mos lejuar foli Hajdini fjalë të mira, po ashtu sepse edhe prindërit obligohen me ligj, në ligj është diku edhe prindi duhet për t’u dënuar po që se dërgon fëmijën në shkollë, ndërsa ne kurrë s’e kemi bërë këtë. Para se të dal te Jagoda se qysh ka ndodhur dhe çfarë ndodhi, unë prapë po e them se do ta kemi parasysh edhe dijen që kam përpara dhe paraprakisht ju kërkoj falje se ndoshta thoni zëri do të jetë jo i përshtatshëm, kërkoj falje se e di ku jam duke folur, do ta kem në maksimum respektin, do të punojmë që argumentet të na shoqërojnë, jo diçka tjetër, vetëm argumentet. U dhanë vërejtjet nga Arbeni, nga Skënderi. Normalisht se arsimit i Klinës është pjesa e arsimit të përgjithshëm në Kosovë. Në Jagodë DKA ka marrë një vendim ligjor, që një arsimtare Arbnore Gashi, që ka qenë që ka zëvendësuar në shkollën fillore “M. Qiriazi”, në paralelen e Zajmit, e cila ka afat kontrate vetëm deri më 5 prill, që ka qenë vetëm zëvendësim, e pranuar atje në mënyrë ligjore dhe konkurs, është marrë vendim për shkak të daljes në pension të Zef Markut, arsimtar i gjuhës shqipe, që të vazhdojë punën brenda sistemit të institucioneve të arsimit të Klinës në shkollën e Jagodës,

mësimdhënëse e gjuhës shqipe, për arsye se e ka të kryer kualifikimin çfarë e kërkon UA, që duhet të jetë baçelar i Fakultetit të Edukimit me programin e kryer gjuhë shqipe dhe letërsi, ajo i ka këto. Këso vendime i ka marrë katër DKA, katër vendime të tilla janë marrë, atje nuk është duke u bojkotuar mësimi, këtu ka filluar për t'u bojkotuar lënda e gjuhës shqipe, besoj që do të ketë zgjidhje, uroj që të ketë zgjidhje, sepse nuk e meritojnë nxënësit atë, nuk e meritojnë bojkotin, as nuk e meritojnë qasjen jo të drejtë nga ana jonë, por ne besoj që kemi shërbyer mirë, e dimë papunësinë, është e vërtetë që ka papuni në Klinë. Dhe është e vërtetë që gjuhë shqipe, histori, gjeografi, edukatë qytetare, kemi kandidatë më së shumti që janë me dhjetëra. Unë besoj që marrja e vendimit që kam marrë për Jagodë bashkë me tri vendimet tjera, që janë në përputhje me sistemimin e brendshëm të punëtorëve. Dhe të potencoj se pse kjo ndikon kështu, tek rëna e numrit të nxënësve, sepse të Ministrisë qesin para në buxhet për kokë të nxënësit, kurse Klina është duke i pasur këto rëniet e numrit të nxënësve për çdo vit, këtë vit i kemi 300 më pak se sa vjet. 21.3 është raporti deri me tash i pandryshuar i formulës së Bankës Botërore për kokë të nxënësit, domethënë sa kokë nxënësit duhet të ketë arsimtari, d.m.th 21.3. Edhe një argument tjetër, sivjet shkau i kësaj rënie të numrit të nxënësve nuk është formuar klasa e parë në Budisalc dhe nuk është formuar klasa e parë në Kërrnicë”, theksoi drejtori Morina.

Pal Berisha, tha se krejt kjo çfarë u tha prej drejtorit, mirëpo nuk e sqaroi edhe një çështje, ka pasur obligim ligjor për të shpallur konkurs, sepse vendi është i lirë. “Në shkollën fillore “Atë Gjergj Fishta”, në Jagodë, drejtori ka pasur për obligim të shpall konkurs. Nuk është fjala kush do të pranohej në atë konkurs, mirëpo është fjala t'u jepet përparësi atyre që janë të diplomuar, por t'u jepet mundësia edhe të atyre të asaj ane që të konkurrojnë me kualitetet e veta, me diplomat e veta. Natyrisht ai është një vend pune nuk i kishin marrë as pesë, as dhjetë, por kishin marrë një punëtor. Mënyrë se si është sjellë drejtori mund ta quan “lëvizje e brendshme”, por aspak nuk ka pasur efekte pozitive. Unë prapë një pyetje shtesë ia bëj drejtorit: a do të kishte bërë shkelje sikur ta kishte shpallur konkursin para afatit që arsimtari i lëndës do të dilte në pension. Dhe pensioni i tij nuk është i befasishtëm”, theksoi anëtarë Berisha.

Hajdin Morina, theksoi se te konkursi në Ligjin e punës shkruan “konkursi”. “Edhe është e vërtetë që kemi rregullore brenda, kemi qarkore të Ministrisë, kemi preferencat e tyre, që konkurset e brendshme të jenë të brendshme, të jashtme, të jashtme. Domethënë se kur të shpallen konkurset e brendshme, po që se ka mundësi të mbulohen më kuadër të brendshëm, do të thotë me kuadër të kualifikuar”, shtoi drejtori Morina, i cili në vijim si argument tregoi rastin e shkuar deri në gjykatë të arsimtarit të biologjisë, Skënder Hoti, që ka përfunduar me zgjidhjen e këtij rasti pa pasur nevojë për ndërhyrje të gjykatës”, theksoi drejtori Morina.

Tunë Dedaj, theksoi që së pari dua ta them se unë personalisht nuk kam kundër që mësuese të punojë në Jagodë, por ajo mësuese e tha edhe vetë drejtori ka pasur kontratë, mirëpo ajo nuk është punëto e rregullt dhe në listën e pagave të Ministrisë së Arsimit. “Këtu keni bërë shkelje, qëllimisht, qëllimisht nuk e keni hapur vendin e punës. Pali e përmendi që arsimtari ka pasur për të dalë në pension, nuk ka qenë i sëmure as nuk ka vdekur, kjo është dashur me kohë për t'u hapur vendi i punës ose për të bërë zgjidhje. Tri ditë i keni lënë nxënësit pa mësues, pa ju dërguar mësuesin fare, tri ditë nuk ka pasur mësues të emëruar. Edhe kisha për të pasur dëshirë, mos ta merr ndokush ndryshe se kishte për të qenë shumë e mirë dhe jam për atë, që një arsimtar i gjuhës shqipe, matematikës, apo fizikës ose cilës do lënë, i Zllakuqanit për të punuar në Gllarevë, e një i Gllarevës për të punuar në Zllakuqan. Kjo është, por duhet konkursi për t'u hapur. Mu duk që kur patëm raportin vjet kemi paguar në gjykatë, për gabime janë paguar ato para. Prandaj, ju garantoj që ty drejtor kanë për t'ju obliguar për të hapur konkursin, sepse nuk ke mundësi të marrësh punëtorin pa konkurs. Unë personalisht jam konsultuar me inspektorë të arsimit. Atëherë çfarë dëshironi për të thënë ti?” – theksoi anëtarë Dedaj.

Sokol Bashota, tha se praktikat e bojkotimit ne i kemi parë edhe disa raste edhe në komunat tjera të Kosovës, për fenomene të ndryshme, qoftë të një simpatie apo të një antipatie të një mësimdhënësi apo të një drejtori të ndonjë shkolle, është bojkotuar mësimi. “Unë mendoj që kjo është akt i ulët, i dënueshëm, dhe nuk do të ishte mirë të stimulohen veprime të kësajll nga askush, pavarësisht po që se ndokush në këtë rast e ka humbur të drejtën e një personi të afërt për ta pasur në atë vend pune, por janë organet kompetente që mund t'u drejtohen që mund të sqarojnë për çdo problematikë. Unë një e di kur kam ardhur këtu dhe kur e kam emëruar drejtorët,

janë hapur konkurset, për ju mund të del shumë e pabesueshme kjo, që asnjëherë për asnjë rast nuk i ndërhyrje dhe nuk i them “merre këtë ose atë”, duke shkelur ligjin, për arsye se ky është përgjegjës për të gjitha veprimet që bëhen në DKA. Dhe për çdo rast veç kalkulohet derisa konkursi del, nuk e kam ditur që është rasti i tillë në këtë shkollë kështu, informacionin e mora këtu dhe insistova që të përfshihet në rend të ditës këtu dhe të debatohet, t’i qasemi seriozisht këtij rasti, nuk është fenomen, uroj të mos bëhet fenomen, që kishte për të shkuar në kaos arsimi, po ashtu edhe shërbimet tjera përgjithësisht, se ne nuk guxojmë të punojmë me teke por me ligj, edhe i kam thënë se ligjërisht a ke pasur të drejtë, vetëm kjo po më intereson. Prandaj, do të kishte qenë mirë që nxënësit për të shkuar në shkollë dhe nuk është asnjë problem ajo punë po që se nesër, pasnesër Inspektorati dhe organet tjera kompetente e bien që është bërë një shkelje dhe duhet udhëhequr një procedurë tjetër. Për çdo rast apo veprim tjetër do të jetë përgjegjësi drejtori në këtë rast. Kryetari ju ka treguar drejtorëve që nuk e mbrojnë punën e asnjërit në qoftë se ai është në kundërshtim me ligjet. Andaj, çdo veprim që ta bëni, konsultohuni mirë me ligjin, veproni në harmoni me te dhe mos u frikoni fare, vetëm respektojeni ligjin. Mirëpo, dini mirë, që arsimi është unik kudo qoftë, në një konkurs në Kaçanik mund të konkurrosh edhe të punosh, se absolutisht nuk ka të bëjë as përkatësia gjinore, as ajo fetare, as tjetra regjionale, më së paku. Por praktikët e sabotimit të mësimi i dini mirë, kjo është një praktikë shumë e keqe, dëshiroj dhe uroj që të jetë rasti i fundit, se përndryshe këto praktika nuk janë të mira. Rugët janë të hapura, pastaj janë procedurat tjera që vijnë. Unë vonë e kam marrë vesh që paska lëndë inxhinieri etj. Unë dhe profa të dytë jemi më fakultet të gjuhës shqipe, që kemi të drejtë për të dhënë mësim vetëm në shkollë të mesme, që do të thotë tash me ligjet e reja janë bërë këto kategorizime dhe e kam, lutur që të jetë shumë i kujdesshëm. Të merret në konsideratë vetëm kualiteti, edhe vetëm një provim po që se ka më tepër le ta ketë përparësinë dhe këtë praktikë kemi për ta ndjekur së bashku edhe në të ardhmen”, konstatoi ndër të tjera kryetari Bashota.

Lorenc Marleku, tha se këtu u fol shumë unë po dëgjoj disa herë se atje në shkollën e Jagodës nuk ka kënd sanitar. “Ka kënd sanitar shkolla e Jagodës apo nuk ka? Kjo është bërë alarm që një vit, nyjat sanitare. Po dëgjoj që 6 muaj, një vit për këtë punë. Thuhet që janë dhënë paratë, nuk janë dhënë paratë, a ka apo nuk ka nyja sanitare në shkollën e Jagodës?”- pyeti anëtarë Marleku.

Hajdin Morina, duke iu përgjigjur pyetjes tha se shkolla e Jagodës ka nyjat sanitare, mirëpo jo në nivel qysh duhet. “Ju e dini që edhe në Planin e Komunës në projekte që janë ndarë para, Jagoda në vitin 2017 për t’iu bërë rinovim objektit të Jagodës. Nuk e di tash sa ato realizohen, përkatësisht a janë para të realizueshme apo veç është planifikuar për Jagodën, sepse kulmin disa herë kemi paraqitur, mirëpo ato janë projekte kapitale që më të vërtetë sivjet në si arsim i kemi shkurtuar edhe pagat e mësimit, po ashtu i kemi shkurtuar edhe shërbimet dhe mallrat. E dyta, desha t’i përgjigjem Tunës, që tha ‘është jashtë sistemit të pagave’, kandidatja ka qenë ëe pranuar nga një program i përbashkët Save Children që është një marrëveshje me Kryetarin që ka nënshkruar, ka investuar 70 për qind të kopshtit të fëmijëve që shpejt do ta kemi edhe përrurimin, edhe me 30 për qind ka marrë Komuna pjesë. Është organizatë që ka investuar edhe në drejtime tjera, jo të objekteve shkollore, por për pagesën e edukatores në Zajm, pagesa i bëhet nga mënyra e pagesës, Komuna e Klinës. Domethënë nxënësit po ashtu janë të Komunës së Klinës. Edhe unë atë kandidate e marr si pjesë përbërëse sikur të gjithë arsimtarët tjerë të Komunës së Klinës. Sado që është një projekt i përbashkët me Save Children dhe Komunës së Klinës, mirëpo ajo ka punuar më fëmijët tanë, edhe më 5 prill ka pasur t’i skadojë kontrata dhe do të ishte e papunë. Domethënë do të ishte e papunë një kandidate që e meriton të punojë sipas UA 6/2015, e ka pikërisht po atë drejtim sipas UA, që nuk e ka krijuar DKA-ja e Komunës së Klinës, por Ministria”, shtoi prof. Morina.

Tunë Dedaj, theksoi se shumë mirë që nuk po e pranoni drejtor, që nuk është në listë të pagave, mirëpo jeni të obliguar për të hapur konkurs. “Këtë rast e ka pasur edhe DSH, e di edhe Kryetari, është dashur për të hapur konkursin dhe për ta pranuar punëtorin të cilin ka qenë duke punuar. Ajo ka punuar, mirëpo tjetërkush e ka paguar. Unë personalisht kërkoj për t’u zbatuar ligji, të hapet konkursi. Prapë po ju them se nuk është asnjë problem që kë do ta pranoni. Merreni atë të cilin është më i miri. Nuk është duke më interesuar prej cilit cep vjen. Nuk kemi asgjë kundër asaj vajze. Kemi kundër mënyrës marrjes së vendimit. Nuk e ke zbatuar ligjin për ta hapur konkursin. Ka pasur të shkojë arsimtari në pension, të hapet konkursi me kohë, të bëhet pranimi me kohë, të mos lihen ata nxënës asnjë ditë opa mësim. Kjo është problematika që unë po e shoh. Vetë e pranove që

nuk është në listë të pagave. Kryetari le të vlerësojë se e ka pasur rastin në SHSH, nuk i ka qitur pa konkurs. Vetëm të zbatohet ligji. Nuk kam asgjë kundër askujt nuk kam”, shtoi anëtari Dedaj.

Ramush Agushi, tha se nuk desha të flas mirëpo fjala e fundit e Tunës në fund më imponojë të inkuadrohem në diskutim. “Sikur të mos kishit pasur diçka kundër asaj vajze nuk e kishit bojkotuar mësimin, mirëpo procedurat i kishit dërguar në gjykatë, kishit vazhduar përmes anës procedurale, përkatësisht me gjykata. Është shumë e rëndë një vajze të tillë t’i bëhet një shkelje e tillë që po i bëhet, që vërtetë ajo vajzë nuk do të jetë në gjendje ndoshta edhe për të dhënë mësim tash e prapa prej atyre torturave që tash po i sheh në atë shkollë. Unë po them, në qoftë se fillojmë me bojkot, ndoshta më së shumti më kishte rënë për të bojkotuar mua në Drenoc dhe Poterq, sepse 30-40 për qind të mësuesve i kemi prej anës së Pejës, edhe kurrë nuk i kemi bojkotuar, por i kemi përkrahur ata mësues. Dhe nuk bojkotohet asnjë mësues i asnjë regjioni dhe për interesa të veta dhe për teke të veta personale, por këtu po që se ka pasur shkelje nga ana e DKA-së lëndën është dashur dërguar në gjykatë apo prokurori, për t’iu drejtuar ndokujt edhe jo për ta bojkotuar në atë mënyrë shkollën dhe kjo po i bien që pikërisht ky është bojkot vetëm i asaj mësuese, e jo e krejt arsimit”, theksoi anëtari Agushi.

Marije Selmanaj, tha se unë desha ta shfrytëzoj rastin pasi që e kemi drejtorin e Arsimit, nuk dua të kyçem në këtë temë, por një pyetje tjetër desha t’ia bëj: Me intereson për ta ditur si janë ndarë më 7 Mars mirënjohjet për arsimtarë, kur e di se para shumë viteve, domethënë për çdo vit kanë qenë dy kritere: kriteri i arsimtarëve të dalluar, apo sipas moshës që kanë shkuar. E sivjet më intereson se si kanë shkuar kjo procedurë. Nuk e kam pretendim për vete se këtë mirënjohje e kam marrë para dy viteve, mirëpo janë duke e dashur të prezantoj shqetësimin e gjithë e arsimtarëve të shkollës që përfaqësoj, që domethënë se në çfarë forme është bërë kjo ndarje e mirënjohjeve, prandaj vetëm desha një sqarim”, theksoi prof. Selmanaj.

Haxhi Ibishi, theksoi se unë konsideroj që kjo pyetje jotja le të jetë e adresuar për Drejtorinë këtë pikë të rendit të ditës të punës së Kuvendit, pyetje-përgjigje.

Pika e nëntë: Pyetje dhe përgjigje nga këshilltarët.

Hajdin Morina, sqaroi pyetjen e anëtares Selmanaj. “Këtë vit, më vjen keq që drejtori i shkollës nuk e ka përcjellë mirë informacionin te ju, nuk kemi ndarë mirënjohje për arsimtarë të dalluar për asnjë. “Kemi dhënë mirënjohje vetëm për nxënës të dalluar nëpër gara dhe olimpiada që kanë përfaqësuar, edhe për pensionistë, që e kemi bërë traditë, DKA-ja prej pasluftës t’u jep pensionistëve nga një orë dore, si shenjë respekti simbolike për t’ju përkujtuar atyre kontributin e orëve kur kanë dhënë mësim, edhe nxënës të dalluar për t’i avancuar. Domethënë për arsimtarë që janë konkretisht në mësim të rregullt nuk kemi ndarë sivjet mirënjohje”, sqaroi drejtori Morina.

Vlora Tafili, tha se e kam njëfarë shqetësimi shumë të madh kur po dëgjoj shumë ankesa kundër “Hidrodrinit”, hajt që nuk ka arritur furnizimin e qytetarëve të Klinës më ujë të pijshëm, nuk është duke i përfunduar disa obligime tjera që i ka, si mirëmbajtjen e kanalizimeve. “Është një gjendje shumë e rëndë në disa fshatra, më e rënda është në fshatin e Sferkës. Edhe duke llogaritur se Komuna e Klinës tashmë ka kontratë më “Hidrodrinin”, edhe e merr një tarifë nga inkasimi i ujit. Pse atëherë nuk i kryen këto obligime?”-pyeti anëtarja Tafili.

Haxhi Ibishi, tha se është drejtoria që mbulon atë sektor.

Gjokë Lleshaj, drejtor i SHPE, tha se rreth mirëmbajtjes së kanalizimeve, shumë e vërtetë është që aty ku ka inkasim është kompetencë e “Hidrodrinit”, por për dijeni, se desha t’u them se viteve të kaluara kemi pasur mjete për mirëmbajtje të kanalizimeve, jo pjesën dërmuese, 80 për qind të atyre mjeteve janë shkuar në Sferkë dhe është bërë mirëmbajtja e kanalizimeve në Sferkë, edhe përkundër që është e obligueshme “Hidrodrini”. “Ne si komunë kemi ndarë mjete, për vitin e kaluar e kam fjalën, kemi pasur mjete dhe kemi pasur mirëmbajtje, këtë vit nuk kemi, sepse “Hidrodrini” është kompetente. Atje ku inkason është përqindja dhe le t’u drejtohen “Hidrodrinit” për mirëmbajtje të kanalizimeve”, sqaroi drejtor Lleshaj.

Skënder Merturi, tha se pyetja e parë, përkatësisht shqetësimi i parë, se e kemi diskutuar disa herë është këtu, edhe e di që kanë qenë disa bisedime, por nuk e di deri ku ka ardhur, transmetimi i seancës në Radio-Alba. “Kryetari shkoi, por ne i subvencionuam klubet, unë besoj që shuma që ka kërkuar Radio - Alba ka mundësi prej Kryetarit për t’u subvencionuar, edhe për t’u transmetuar seancat drejtpërdrejt në Radio - Albë. Duhet për t’u gjetur mjetet, diku 3 mijë euro ka kërkuar Radio - Alba. E dyta, shkon në kompetencë të drejtorit të SHPE, kur i ka vizituar për herë të fundit varrezat dhe a i ka parë në çfarë gjendje të mjerueshme janë varrezat e dëshmorëve në “Kodrën e Kuqe”. Unë i vizitoj shumë shpesh, është një gjendje për keqardhje. Ato varreza janë shumë-shumë në gjendje të mjerueshme. Kisha kërkuar prej drejtorit një sqarim, a ka menduar ndonjëherë të shkojë dhe t’i shoh dhe të shikojë të ndërmerr një hap në atë drejtim, përkatësisht në çfarë gjendje janë ato varreza”, theksoi anëtari Merturi.

Tunë Dedaj, tha se drejtorit të Shërbimeve Publike ju pata drejtuar më herët, mirëpo nuk ia dhatë fjalën. “Kisha pasur dëshirë të di që një kontratë që ka qenë e bërë me një firmë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, pse ajo, e kam dëgjuar se është tërhequr se nuk do të sjellë rërë të kualitetit të mirë, por do të sjell llaç aty, nuk e kanë lënë, kështu e kam dëgjuar, edhe çka është duke u bërë me atë punë? “Pse nuk i ndërpritet asaj dhe të merret kompania tjetër, sepse rrugët janë në gjendje të pakalueshme nëpër fshatra”, shtoi anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, theksoi se duam të takohemi, ditën e martë ose të mërkurë, të precizohemi për të përfshirë në konturë këtë çështje. “Unë edhe herën e kaluar kërkoja të takohemi ne, duke e parë që edhe 2-3 grupe parlamentare nuk po them që janë shturur, por nga pak kemi parë, Petrit ka dalë nga Grupi, G3, në grupin e AAK-së. Profesor Ndou që kemi qenë në një vijë më herët, ne kemi kaluar në PDK para një viti e gjysmë, janë diçka që, domethënë me shefat e GP, ose me kryetarë të partive, unë dhe Kryetari jemi të interesuar për ta bërë një rikomponim ose secili ta ruajë subjektivitetin e vet edhe ashtu respektohet. Prandaj edhe këtë çështjen pyetje-përgjigje do ta fusim në njëfarë konture të mos e lëmë pa kufi dhe të mos e lëmë, përkatësisht për ta gjetur një formë kur është më atraktive edhe më e kontrollueshme”, shtoi kryesuesi Ibishi.

Elvira Sejdiqaj, tha se kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Emergjente rreth mirëmbajtjes së ndriçimit publik: “Sa është punuar në këtë drejtim, kur e dimë se në disa lagje vetë qytetarët kanë participuar për vënien e dritave. Tash mbasi janë prishur ato poqa elektrike dhe prapë po detyrohen qytetarët për të participuar edhe për ndreqjen e këtyre dritave. Sa keni punuar ju si drejtori për të mos dëmtuar qytetari? Edhe, nëse më lejohet desha të më përgjigjet drejtori i Arsimit për punën e tij, pasi foli edhe Marija, e ndjej për obligim t’ia them 2-3 fjalë: Pasi kam qenë vetë që kam konkurruar në shumë konkurse, domethënë jam dëshmitare e shumë kandidatëve që janë marrë në punë, përkatësisht janë përzgjedhur, unë e përgëzoj drejtorin që e ka këqyrë cilësinë e arsimit dhe jo librezat e partisë që është folur shumë më herët, prandaj e përgëzoj që e ka gjetur cilësinë e kandidatëve në arsim, shtoi anëtarja Sejdiqaj.

Enver Gashi, tha se kam dy pyetje për drejtorin e arsimit: në komunën tonë kemi 3 shkolla që janë pilot, domethënë kurrikulë, kur do të hynë shkollat tjera, pyetja e parë. “Dhe, pyetja e dytë është, Kuvendi i Komunës e ka miratuar Rregulloren për masat disiplinore dhe kodin e mirësjelljes me të gjitha institucionet, Orët e kujdestarisë kur do të hynë dhe a do të paguhen kur dihet se në Kodin e mirësjelljes janë edhe orët e kujdestarisë?” - tha anëtari Gashi.

Rasim Millaku, tha se unë kam për ta ngritur një shqetësim për zonën nga vi, jemi në hall, besoj se e gjithë Klina ka të njëjtin hall, prej qenve endacakë. “Kam dëgjuar një prej seancave të kaluara që është duke u ndërmarrë diçka për eliminimin e tyre, por thjesht nuk e di deri ku është, sikur të ishte drejtori përkatës këtu na u kishte përgjigjur, përndryshe që të përcjellët ky shqetësim, sepse jemi në hall të madh. Qentë endacakë po shtohen dita-ditës edhe paraqesin rrezik të madh, sidomos për fëmijët. Edhe të dytën pak si alegori, kisha për ta falënderuar Kryesuesin se disa lapë – topë na janë “prishur”, tha anëtari Millaku.

Gjokë Lleshaj, tha se do t’i përgjigjem këtij të “Vetëvendosjes”, a janë në kuadër të kompanisë ata punëtorë që ke bërë pyetje më herët, mund t’i pyesësh a kanë vendim apo nuk kanë, qysh janë të pranuar shko e pyeti ata.

Duhet ta dish se mirëmbajtjen e pastrimit të qytetit e bën “Ambienti” dhe të dish se ke punë me “Ambientin”, qysh janë marrë në punë shko pyeti ata! Edhe mirëmbajtjen e varrezave, lufto për të siguruar mjete, çdo mjet që sigurohet, përkatësisht që ndahet për to, unë do t’i investoj aty. Pyetje me vend rreth ndriçimit publik, po më vjen mirë që një kohë të gjatë vërtet ka pasur vështirësi edhe probleme Komuna e Klinës për ndriçim publik, edhe vitin e kaluar kemi bërë një punë bukur të madhe, ku janë investuar bukur shumë mjete prej buxhetit të Komunës, por edhe falë edhe donatorëve, që ju edhe i keni votuar dhe i keni përkrahur. Ndriçimi publik vitin e kaluar ka përfunduar diku një projekte 45 kijë euro prej buxhetit të Komunës, pastaj plus donacione që kemi marrë prej USAID-t, që është bërë mbi 0pjesën e shkollës “Ismet Rraci” në drejtim kah është “Hidrodrini”, atyre rrugëve. Rreth mirëmbajtjes, vitin e kaluar përkundër kërkesave të mia që kam bërë për planifikim për ndarje të buxhetit, për këtë vit, nuk është bërë, por prapë e kemi bërë një zgjidhje, ju e keni votuar një 20 mijë euro për ndarjen e mirëmbajtjes së ndriçimit publik dhe Ministria na ka miratuar. Tani jemi në faza të tenderimit që mund ta përzgjedhim një kompani dhe të keni durim, edhe të mbajmë mirëmbajtjen, sepse ne edhe kontratën e kemi për mirëmbajtje, mirëpo kemi nevojë për ndonjë shtrirje, meqenëse i kemi siguruar ato mjete, kërkoj falje derisa të sigurohet kompania edhe ta bëjmë mirëmbajtjen edhe shtrirje sado të vogël. Besoj që në këtë pikë jemi bukur të qartë dhe kemi punuar dhe do të punojmë në këtë drejtim në momentin që na jepet rasti. E njëjta është për qentë endacakë, që i kemi iniciuar procedurat, një kërkesë e kemi pasur bërë për lejin e eliminimit fizik dhe na kanë dhënë pëlqimin, i kemi iniciuar procedurat, tani deri në cilën fazë është mund të pyetet Zyra e prokurimit, sepse unë me kohë i kam proceduar të gjitha procedurat dhe i kam kryer. Në momentin kur të vjen kontrata do ta zbatoj. Tuna e ka bërë një pyetje edhe më herët, kur janë pyetjet me vend dhe të arsyeshme, është mirë që edhe të sqarohen deri në skaj, sepse është mirë të mos lëmë dilema, të mos thotë ndokush se është duke u fshehur, duke u thënë apo nuk është duke u ditur, le të dihet çdo gjë që çka është. Për mirëmbajtjen verore kemi pasur siguruar mjete, nëse nuk shpenzohet mirëmbajtja dimërore, ato mjetë për t’u bartur te shpenzimet për mirëmbajtje verore. Dhe thënë të drejtën patën fat që nuk kemi shpenzuar. Ne kemi një kompani të kontraktuar për mirëmbajtje verore. Dhe është kontraktuar diku në janar përkundër do shtyrjeve që janë bërë për mua sot për sot të paarsyeshme, por e kemi zgjedhur një kompani. Kompania ka filluar me mirëmbajtjen e rrugëve në bazë të kërkesave tona edhe raportet e inspektorëve të gjendjes aktuale kanë filluar që të bëhen disa mirëmbajtje me zhavorr. Mirëpo, organi mbikëqyrës më dt. 26.1.2016, ka paraqitur vërejtjet e veta ndaj këtij operatori. Dhe mbasi më është ofruar edhe mua vërejtja nga organi mbikëqyrës kam proceduar dhe kam bërë vërejtjen prapë me shkrim Zyrës së prokurimit, e cila është nënshkruese kontratës me atë operator ekonomik dhe më gjitha faktet. Unë flas vetëm për vete për askënd tjetër. Kam provuar të kontaktoj me operatorin dhe kam biseduar, mirëpo nuk e ka shfaqur një gatishmëri për ta vazhduar punën. Arsyeja e komisionit ka qenë: Një, nuk ju ka përmbajtur cilësisë të zhavorrit të cilin e kemi në kontratë. Kontraktuesi e ka mohuar dhe ka kundërshtuar këtë punë dhe nuk e ka vazhduar punën. Kemi pasur takim me operatorin edhe në Zyrën e kryetarit me kërkesën që ta vazhdojë punën në bazë të kontratës pikur për pikë, mirëpo operatori prapë nuk e ka vazhduar të njëjtën punë. Zyra e prokurimit tani për tani nuk di ku ka mbërri me zotuar, sepse ajo është për të nënshkruar një kontratë me këtë operator ekonomik. Këtu i kam të gjitha dëshmitë që i jam drejtuar edhe Zyrës së Kryetarit, edhe Zyrës së Prokurimit, mirëpo tash për tash gjendja është kështu siç është edhe kjo kompani duhet t’i përgjigjet ZP, sepse ajo është nënshkruese e një kontrate të tillë. E di që gjendja është e keqe, e di që gjendja do pak emergjencë, mirëpo dhe nga ju që jeni këtu prezent, edhe ata që nuk janë këtu prezent, kryetarët e fshatrave, BL-ve etj., kanë kërkuar shumë herë, pse nuk është duke u intervenuar, mirëpo të mos mbetet se ne si Komunë nuk kemi ndërmarrë hapa tani. Procedurat ligjore unë nuk i di çfarë duhet të veprohet, prandaj le të merret ai që është kompetent. Unë e di që ju keni shqetësimet e juaja, mirëpo kjo është e tëra ajo që unë mund t’ju sqarojë”, konstatoi i drejtori Lleshaj.

Vlora Tafili, tha se dikush është duke keqpërdorur, dhe për t’i çuar temat deri në fund, jo vetëm me pyetje dhe përgjigje dhe po harrohet të gjitha gjerat, sikur u harruar çështja e qenve endacakë etj. “Ka për detyrë për t’i mirëmbajtur kanalizimet, edhe ndahen mjetet nga faturat e inkasimit të ujit. Komuna e Klinës ka fuqi për të marrë edhe vendim”, tha anëtarja Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se e para, desha për t'ju kërkuar falje gjithkujt që e ka çmuar se e kam lënduar gjatë fjalorit në këtë seancë, për një arsye të vetme: "Nuk ka thënë për t'u trajnuar ndokush individualisht, por që duhet trajnuar kolektivisht po e shoh që kemi nevojë. Vetë fakti që nuk keni nevojë për t'ju drejtuar në mënyrë personale, drejtorit i drejtoheni në vijën personale, s'ke nevojë, t'i diskuton me ne, me këshilltarët, drejtori është kompetent për t'u përgjigjur ty në atë shqetësimin tënde dhe përfundon me kaq. Janë organet tjera të cilat e kërkojnë kush e ka pasur të drejtë apo jo, kemi gjykatën", tha Kryesuesi.

Gjokë Lleshaj, tha vetëm një sqarim: atje ku bëhet inkasim dhe paguhet, Vlora të jesh e sigurt se le të vijnë nga cilido vend dhe nuk është bërë pastrimi i kanalizimit jam përgjegjës, edhe unë kam për t'u marrë me kompaninë e "Hidrodrinit". Le të jetë cilido vend nuk e di se ku e ke fjalën për shembull", tha drejtori Lleshaj.

Lorenc Marleku, tha se desha të pyes në Rregullore sa pyetje grupi parlamentar ka të drejtë anëtari për t'i bërë?

Haxhi Ibishi, tha se kjo është një temë do ta fusim në sistem bashkë me udhëheqësit e GP dhe kryetarëve të partive. "Nuk e kemi të definuar akoma. Ne kemi menduar për të kalua 15 minuta, për të qenë krejt interdebati 15 minuta, për të mos ia kufizuar të drejtën e askujt. Ju vetëm po e shihni që një këshilltar po e merr të drejtën për të bërë 3-4 pyetje, të cilat po në shtyjnë në 3-4 limite të ndryshme. Nuk ka AK që ka lejuar këtë debat kaq transparent. Kjo është gatishmëria jonë, nuk është mirë për t'u keqpërdorur, ne jemi të interesuar për t'i futur brenda kësaj suaze, qoftë në GP për të pasur të drejtë për të pasur të drejtë 2 ose 3 pyetje. Javën që vjen do t'i thërras kryetarët e GP le të merremi vesh qysh do ta bëjmë këtë organizim", tha kryesuesi.


Lorenc Marleku, tha se edhe përgjigja le të jetë një pyetje, nuk po janë drejtorët në fund dhe kjo po bëhet në fund.

Haxhi Ibishi, tha se shefi juaj i GP le t'i merr vërejtjet e juaj, i LDK-së, PDK-së dhe i harmonizojmë. "Ju falënderoj për punën. Të gjithë shqiptarëve të besimit katolik ju uroj Ditën e Pashkëve me urimin: "Me shëndet Pashkët!"- përfundoi Kryesuesi, Dr. Ibishi.

Kryesuesi seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 13.30 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi IBISHI

